

ност со одредбите од Законот за спречување на корупцијата („Службен весник на Република Македонија“ број 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 и 148/15) и Законот за спречување на судир на интереси („Службен весник на Република Македонија“ број 70/2007, 114/2009, 6/12 и 153/15) и подзаконските акти кои произлегуваат од нив.

(4) Анкетните листови, изјавите за интереси и пријавите за промени во имотната состојба поднесени до денот на влегувањето во сила на подзаконските акти од ставот (1) на овој член, се сметаат за поднесени изјави за имотна состојба и интереси, односно пријави за промени во имотната состојба согласно со овој закон.

(5) Државната комисија во рок од 60 дена од нејзиното конституирање ќе пропише образец за изјава за имотна состојба и интереси.

(6) Лицата кои немале обврска да поднесуваат анкетни листови и изјави на интереси, согласно со Законот за спречување на корупцијата („Службен весник на Република Македонија“ број 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 и 148/15) и Законот за спречување на судир на интереси („Службен весник на Република Македонија“ број 70/2007, 114/2009, 6/12 и 153/15), се должни да поднесат изјава за имотна состојба и интереси во рок од 30 дена од денот на пропишување на образецот од ставот (5) на овој член.

(7) Државната комисија има право да донесе одлука за објавување повик до лицата кои поднеле анкетни листови и изјави на интереси, согласно со Законот за спречување на корупцијата („Службен весник на Република Македонија“ број 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 145/10, 97/15 и 148/15) и Законот за спречување на судир на интереси („Службен весник на Република Македонија“ број 70/2007, 114/2009, 6/12 и 153/15) да достават изјави на образецот од ставот (5) на овој член во рок од 30 дена од денот на објавување на повикот.

#### Член 120

(1) Во рок од еден месец од денот на именувањето на претседателот и на членовите на Државната комисија согласно со одредбите на овој закон, Државната комисија организира преземање на анкетните листови, изјавите за интереси и пријавите за промени во имотната состојба кои административни службеници од категоријата А утврдена со закон ги поднеле до институциите, односно органите во кои се назначени. Преземањето го спроведува комисија формирана од Државната комисија.

(2) Институциите односно органите во кои се назначени административни службеници од категоријата А утврдена со закон се должни да постапат по барањата коишто Државната комисија им ги упатува заради спроведувањето на преземањето од ставот (1) на овој член.

#### Член 121

Со влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за спречување на корупцијата („Службен весник на Република Македонија“ број 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 и 148/15) и Законот за спречување на судир на интереси („Службен весник на Република Македонија“ број 70/2007, 114/2009, 6/12 и 153/15).

### Влегување во сила на законот

#### Член 122

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

## L I G J PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

### Kapitulli i parë

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Qëllimi i ligjit

##### Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohen masat dhe aktivitetet për parandalim të korrupsionit në ushtrimin e pushtetit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare dhe politikës, masat dhe aktivitetet për parandalim të korrupsionit gjatë kryerjes së punëve me interes publik të personave juridikë në lidhje me realizimin e autorizimeve publike.

(2) Për zbatim të masave dhe aktiviteteteve nga paragrafi (1) i këtij neni kompetent është Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit.

#### Përkufizimi i korrupsionit dhe konfliktit të interesave

##### Neni 2

(1) Me korrupsion, në aspekt këtij ligji, nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës apo pozitës zyrtare për realizim të dobisë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, për vete ose për tjetër person.

(2) Nocioni korrupsion, në aspekt të këtij ligji, i përfshin nocionet e:

- **korrupsionit pasiv** – veprim i qëllimshëm i personit zyrtar, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi, kërkon ose pranon dobi në cilëndo formë, për vete ose për person të tretë, ose pranon premtim për dobi të këtyllë, me qëllim të veprjës ose të përmbahet prej veprimit në pajtim me obligimet e tij ose të i ushtrojë kompetencat e tij në kundërshtim me obligimet zyrtare dhe

- **korrupsionit aktiv** - veprim i qëllimshëm i cilit do person i cili drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, premtim ose jep dobi në çfarëdo forme për person zyrtar, për vete ose person të tretë, me qëllim të veprjës ose të përmbahet prej veprimit në pajtim me obligimet e tij në kundërshtim me obligimet zyrtare.

(3) Me konflikt të interesave nënkuptohet gjendja në të cilën personi zyrtar ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi kryerje të paanshme të autorizimeve të tij publike ose detyrave zyrtare.

#### Parimi i ligjshmërisë

##### Neni 3

(1) Secili është i obliguar në kryerjen e funksionit, autorizimeve publike dhe detyrës zyrtare të veprjës në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet.

(2) Askush nuk guxon ta shfrytëzojë funksionin, autorizimin publik, detyrën dhe pozitën zyrtare për kryerje ose lëshim të veprimit që sipas ligjit nuk guxon, përkatësisht doemos duhet ta kryejë, as ta nënrendojë kryerjen e veprimit ligjor në interes të vet personal, as në interes të personit tjetër.

(3) Askush nuk mund të thirret në përgjegjësi për korrupsion përveç në rastet dhe kushtet e parapara me këtë ligj, me Kodin penal dhe ligj tjetër dhe në procedurë të caktuar me ligj.

**Parimi i integritetit**

## Neni 4

(1) Secili është i obliguar në kryerjen e funksionit, autorizimit publik dhe detyrës zyrtare të veprorë me ndërgjegje, profesionalisht, me përgjegjësi, ndershmëri, efikasitet dhe paanshmëri.

(2) Personi zyrtar në kryerjen e autorizimeve dhe detyrave publike është i obliguar t'i respektojë parimin e ligjshmërisë, parimin e barazisë, normat etike dhe standardet profesionale, pa diskriminim ose favorizim të cilit do me respektim të plotë të interesit publik.

(3) Personi zyrtar në ushtrim të funksionit të tij është i obliguar të ketë kujdes për konflikt eventuale të interesave dhe gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave zyrtare, nuk guxon të bazohet në interesat e tij personale, familjare, fetare, partiake dhe etnike, as presione dhe premtime nga ana e eprorit ose personit tjetër.

**Parimi i barazisë**

## Neni 5

(1) Secili ka të drejtë për qasje të barabartë në kryerjen e punëve me interes publik dhe të drejtën për veprim të barabartë nga ana e bartësve të pushtetit dhe personave të cilët kryejnë autorizime publike dhe detyra zyrtare.

(2) Secili ka të drejtë për paraqitje të lirë në treg dhe në garë të lirë, pa frikë se mund të jetë viktimë e sjelljes së monopolit ose diskriminuese.

(3) Secili ka të drejtë për të parandaluar ose denoncuar korrupsion ose moskryerje, përkatësisht lëshim që paraqet shfrytëzim të funksionit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare për t'i shkaktuar dëm tjetrit, pa pësuar kurrfarë pasojash.

**Parimi i publicitetit**

## Neni 6

(1) Ushtrimi i pushtetit, funksionit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare dhe punëve të interesit publik janë publike dhe i nënshtrohen kontrollit publik.

(2) Askush nuk mund të thirret në aplikim të ligjit ose dispozitës tjetër me të cilën do të kufizohet ose përjashtohet publiciteti për t'u mbuluar korrupsioni ose konflikti i interesave.

**Parimi i mbrojtjes dhe përgjegjësisë**

## Neni 7

(1) Secili ka të drejtë për të paraqitur dyshim ose njohuri për korrupsion dhe të jetë i mbrojtur në pajtim me ligj.

(2) Secili që është i dëmtuar me vepër korruptuese ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim dhe fitim të humbur, sipas parimeve të përgjegjësisë solidarë nga ana e kryerësit të korrupsionit, si dhe nga personi juridik në të cilin kryerësi ka ushtruar funksion ose detyrë në kohën e kryerjes së veprës.

(3) E drejta nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të realizohet kur vepra korruptuese është konstatuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

**Kuptimi i shprehjeve të përdorura në këtë ligj**

## Neni 8

(1) Për përcaktim të kuptimit të shprehjeve person i zgjedhur ose i emëruar, person juridik, person përgjegjës në person juridik dhe person që kryen punë të interesit publik, aplikohen dispozitat për kuptim të shprehjeve nga Kodi penal.

(2) Me nocionin "person zyrtar" nënkuptohen të gjithë personat e zgjedhur ose emëruar dhe të punësuarit në sektorin publik.

(3) Me nocionin "familje" në aspekt të këtij ligji, nënkuptohen bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe familjarët tjerë me të cilët personi nga paragrafi (1) i këtij neni jeton në ekonomi të përbashkët familjare.

(4) Me nocionin "persona të afërt" nënkuptohen persona në bashkësi martesore ose jashtëmartesore me personin zyrtar, farefis sipas gjakut në vijë të drejtë ose anësore deri në shkallë të katërt, farefisi sipas krushqisë deri në shkallë të dytë, si dhe çdo person fizik ose person juridik me të cilin personi zyrtar ka interes financiar.

(5) Me nocionin "dobi" nënkuptohet realizim i çdo lloji përfitim material ose jomaterial, përfitimi, volitshmërie ose avantazhi për vete ose për person tjetër.

(6) Me nocionin "trezik nga korrupsioni" nënkuptohet çdo lloji dobësisë së brendshme ose të jashtme ose procedurë që paraqet mundësi për paraqitje të korrupsionit në kuadër të organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve tjera të sektorit publik dhe që i përfshin çështjet për konflikt interesash, mospërputhshmëri të funksioneve, pranim dhuratash dhe pagesa tjera ilegale, lobim, mungesë të sistemit për mbrojtje të denoncuesve, mashtrime, shfrytëzim joadekuat të autorizimeve, autorizime diskrete, financim të partive politike dhe fushatave në kundërshtim me ligj, tregti ose shfrytëzim të palejuar të informatave, transparencë në procedura dhe dokumente si dhe çështje tjera të rëndësishme për integritetin.

(7) Me nocionin "integritet" nënkuptohet kryerje ligjore, e pavarur, e paanshme, etike, përgjegjëse dhe transparente e punëve me të cilat personat zyrtarë e mbajnë reputacionin e vet dhe prestigjin e institucionit në të cilin janë person përgjegjës, përkatësisht të punësuar, i eliminonjë rreziqet dhe i mënjanonjë dyshimet në mundësinë për ekzistim dhe zhvillim të korrupsionit dhe me atë sigurojnë besim të qytetarëve në ushtrimin e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike.

(8) Me nocionin "interes publik" nënkuptohet mbrojtja e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, parandalimi i rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe e natyrës, mbrojtja e pronësisë dhe e lirisë së tregut dhe sipërmarrësish, sundimi i së drejtës dhe parandalimi i krimit dhe korrupsionit.

(9) Me nocionin "autorizim publik" nënkuptohet autorizimi, i bartur nga ana e pushtetit shtetëror ose lokal, personit fizik ose juridik që të kryejë punë me interes publik.

(10) Me nocionin "detyrë zyrtare" nënkuptohet shumica e obligimeve të cilat një person detyrohet t'i ndërmarrë, e të cilat dalin nga kryerja e funksionit ose profesionit të caktuar, përkatësisht nga pozita zyrtare e atij personi.

(11) Me termin "punë administrative" nënkuptohen punë administrative-profesionale, normative-juridike, statistikore, të planit, informatike, kadrovike, materiale, financiare, kontabiliste, informative dhe punë tjera të natyrës administrative.

## Kapitulli i dytë

KOMISIONI SHETËROR PËR PARANDALIM TË  
KORRUPSIONIT

## Statusi dhe përbërja

## Neni 9

(1) Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Shtetëror) është i mëvetësishëm dhe i pavarur në kryerjen e punëve të caktuara me këtë ligj dhe ka cilësi të personit juridik.

(2) Komisioni shtetëror përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë.

(3) Komisioni shtetëror ka Sekretariat si shërbim profesional i Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: Sekretariati).

(4) Me Sekretariatit udhëheq sekretari i përgjithshëm.

#### **Zgjedhja dhe emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit shtetëror**

##### Neni 10

(1) Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për periudhë prej pesë vitesh, pa të drejtë rizgjedhjeje. Personi i cili në një mandat e ka ushtruar funksionin kryetar i Komisionit Shtetëror ose anëtar i Komisionit Shtetëror, nuk mund të zgjidhet më as për kryetar, as për anëtar të Komisionit shtetëror.

(2) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit shtetëror zgjidhen në konkurs publik të cilin e shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në pajtim me këtë ligj.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit shtetëror nga radhët e anëtarëve të Komisionit shtetëror zgjedhin zëvendëskryetar të Komisionit shtetëror, me shumicë të votave nga përbërja e përgjithshme e Komisionit shtetëror, sipas parimit të rotacionit në çdo gjashtë muaj.

(4) Në rast të ndërprerjes së funksionit të kryetarit përkatësisht anëtarit të Komisionit shtetëror para skadimit të mandatit, zgjidhet kryetar i ri përkatësisht anëtar i Komisionit shtetëror me mandat prej pesë viteve.

#### **Kushtet për emërim të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit shtetëror**

##### Neni 11

(1) Si kryetar i Komisionit shtetëror mund të emërohet person i cili i plotëson këto kushte:

a. të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë;

b. të ketë aftësi për punë;

c. të ketë arsim të lartë me 300 SETK të fituara ose shkallën VII/1 për arsim të mbaruar në sferën e shkencave juridike ose arsim të lartë me 240 SETK kredi të fituara ose shkallën VII/1 të mbaruar për arsim nga sfera e shkencave politike, të komunikologjisë ose ekonomike;

ç. të ketë së paku dhjetë vjet përvojë pune pasi të ketë mbaruar arsim të lartë, prej të cilave së paku tetë vite në fushat e zbulimit ose parandalimit të korrupsionit, sundim i së drejtës ose menaxhim të mirë;

d. të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

dh. në dhjetë vitet e fundit të mos ketë qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, anëtar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, të mos ketë qenë donator i partisë politike ose të mos ketë ushtruar funksion në organe të partisë politike;

e. nuk e ka shfrytëzuar të drejtën nga neni 10 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Si anëtar i Komisionit shtetëror mund të emërohet person i cili i plotëson kushtet në vijim:

a. të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë;

b. të ketë aftësi për punë;

c. të ketë arsim të lartë me 300 SETK të fituara ose shkallën VII/1 për arsim të mbaruar në sferën e shkencave juridike ose arsim të lartë me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallën VII/1 të mbaruar për arsim nga sfera e shkencave politike, komunikologjike ose ekonomike;

ç. të ketë së paku dhjetë vjet përvojë pune pasi të ketë mbaruar arsim të lartë, prej të cilave së paku gjashtë vite në sferat e zbulimit ose parandalimit të korrupsionit, sundim i së drejtës ose menaxhim të mirë;

d. të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

dh. dhjetë vitet e fundit të mos ketë qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, anëtar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, të mos ketë qenë donator i partisë politike ose të mos ketë ushtruar funksion në organe të partisë politike;

e. nuk e ka shfrytëzuar të drejtën nga neni 10 paragrafi (1) i këtij ligji.

#### **Procedura për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror**

##### Neni 12

(1) Procedura për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit shtetëror fillon tre muaj para skadimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve ekzistues të Komisionit shtetëror.

(2) Në rast të shkarkimit përkatësisht ndërprerjes së funksionit të kryetarit përkatësisht anëtarit të Komisionit shtetëror para skadimit të mandatit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë fillon procedurë për zgjedhje të kryetarit përkatësisht anëtarit të ri të Komisionit shtetëror në afat prej 10 ditëve nga pushimi i mandatit.

(3) Procedura për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit shtetëror, fillon me shpallje të konkursit publik për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të ri të Komisionit shtetëror, ndërkaq e zbaton Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shpall konkursin nga paragrafi (3) i këtij neni, në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe së paku në tri gazeta ditore që botohen në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, prej të cilave dy gazeta që botohen në gjuhën maqedonase dhe një prej gazetave që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që flasin gjuhë tjetër nga gjuha maqedonase. Konkursi shpallet edhe në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe të Komisionit shtetëror.

(5) Afati për paraqitje të kandidatëve për konkursin nga paragrafi (3) i këtij neni është dhjetë ditë nga dita e publikimit të konkursit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(6) Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej dhjetë ditësh nga shpallja e konkursit nga paragrafi (3) i këtij neni formon Komision për seleksionim të kandidatëve për kryetar dhe për anëtarë të Komisionit shtetëror (në tekstin e mëtejme Komisioni për seleksionim).

(7) Komisioni për seleksionim përbëhet prej shtatë anëtarëve:

- një anëtar i nominuar nga Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë,

- përfaqësuesi i shoqatës përkatësisht fondacionit i emëruar si anëtar në Këshillin për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe sektorit civil për sferën Demokraci dhe sundim i së drejtës,

- përfaqësuesi i shoqatës përkatësisht fondacionit i emëruar si anëtar në Këshillin për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe sektorit civil për sferën Mediume dhe shoqëri informatike,

- dy deputetë nga pushteti,

- dy deputetë nga opozita.

(8) Përkrahje administrative Komisionit për seleksionim i jep njësia organizative e Shërbimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që u jep përkrahje trupave punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(9) Në afat prej tri ditësh nga skadimi i afatit për paraqitje nga paragrafi (5) i këtij ligji, Komisioni për seleksionim kontrollon plotësimin e kushteve nga 11 i këtij ligji dhe përcakton listë të kandidatëve të paraqitur me të dhëna se cilët prej tyre i plotësojnë kushtet.

(10) Lista nga paragrafi (9) i këtij neni publikohet në tërësi në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, me të dhëna për plotësimin e kushteve nga neni 11 i këtij ligji, menjëherë, kurse më së voni në afat prej një dite nga dita e përcaktimit të saj.

(11) Në afat prej pesë ditëve nga publikimi i listës nga paragrafi (6) i këtij neni, organizohet intervistë e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet nga neni 11 i këtij ligji (në tekstin e mëtejshëm: intervista) që emetohet në Kanalin e Kuvendit. Nëse ndonjëri prej kandidatëve nuk vjen në intervistë, konsiderohet se e ka tërheq fletëparaqitjen për kryetar ose anëtar të Komisionit shtetëror.

(12) Termimi për mbajtje të intervistës publikohet në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me ditën e publikimit të listës nga paragrafi (9) i këtij neni.

(13) Intervistën e zbaton Komisioni për seleksionim në mbledhje publike të Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(14) Mënyra e mbajtjes së intervistës, vlerësimi dhe rangimi i kandidatëve përcaktohet me akt të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

(15) Njëkohësisht me shpallje të konkursit nga paragrafi (3) i këtij neni, në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë publikohet ftesë për Avokatin e Popullit, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë dhe Konferencën Interuniversitare në afat prej dhjetë ditëve nga publikimi i ftesës që të nominojnë përfaqësues të tyre që do të marrin pjesë në intervistë.

(16) Njëkohësisht me shpalljen e konkursit nga paragrafi (3) i këtij neni, në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë shpallet thirrje për shoqatat e gazetarëve, shoqatat tjera dhe fondacionet që të marrin pjesë në intervistën, në pajtim me paragrafin (17) të këtij neni. Afati për paraqitje në thirrje është dhjetë ditë nga dita e publikimit të saj.

(17) Të gjitha shoqatat e gazetarëve që janë të themeluara në pajtim me ligj përkatësisht të regjistruara më tepër se pesë vite dhe çdo shoqatë ose fondacion i regjistruar në pajtim me ligj dhe me përvojë prej së paku pesë vite në fushën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të së drejtës ose menaxhimit të mirë, kanë të drejtë të paraqiten në thirrjen dhe të marrin pjesë në intervistë, me nga një përfaqësues për të cilin dorëzojnë të dhëna për identifikim.

(18) Krahas deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe përfaqësuesve të paraqitur, përkatësisht të nominuar në pajtim me paragrafët (15) dhe (19) të këtij neni kanë të drejtë të shtojnë pyetje për kandidatët për kryetar përkatësisht anëtarë të Komisionit shtetëror gjatë kohës së intervistës.

(19) Në afat prej tri ditëve nga zbatimi i intervistës, Komisioni për seleksionim përcakton rang listë të kandidatëve në pajtim me kriteret e përcaktuara me aktin nga paragrafi (14) dhe e dorëzon te Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë i cili kandidatët më të mirë të ranguar ia propozon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në propozim listë të vetme për kryetar dhe anëtarë të Komisionit shtetëror, me arsytim për secilin prej kandidatëve të propozuar.

(20) Nëse Komisioni për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nuk e përcakton listën nga paragrafi (19) i këtij neni në afatin e caktuar, Kuvendi diskuton dhe voton veçmas për secilin prej kandidatëve që i plotësojnë kushtet në pajtim me rang listën e përpiluar nga Komisioni për Seleksionim.

(21) Nëse Kuvendi nuk zgjedh kryetar dhe anëtarë të Komisionit shtetëror, procedura për zgjedhje përsëritet në tërësi me shpallje të konkursit, menjëherë ndërkaq jo më vonë se në afat prej dhjetë ditëve.

(22) Në procedurën për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit shtetëror merren parasysh parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat dhe parimi i përfaqësimit të barabartë gjinor.

(23) Kandidatët për kryetar ose anëtar të Komisionit shtetëror të cilët vlerësojnë se në procedurën për zgjedhje të kryetarit ose anëtarit të Komisionit shtetëror janë shkelur dispozitat nga nenet (10), (11) dhe (12) të këtij ligji kanë të drejtë për padi në Gjykatën Administrative. Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

### **Statusi i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror**

#### Neni 13

(1) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit shtetëror kanë status të personave të emëruar.

(2) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit shtetëror funksionin e kryejnë në mënyrë profesionale dhe me orar të plotë të punës.

(3) Funksioni kryetar përkatësisht anëtar i Komisionit shtetëror është i papërputhshëm me kryerje të funksionit tjetër publik, profesionit ose funksionit në parti politike.

(4) Kryetarit të Komisionit shtetëror i paguhet rrogë e përcaktuar me koeficientin për përcaktimin e rrogës së nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktuar me ligjin me të cilin përcaktohen rrogat e personave të zgjedhur dhe të emëruar.

(5) Anëtarit të Komisionit shtetëror i paguhet rrogë e përcaktuar me koeficientin për përcaktim të rrogës së deputetit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin me të cilin përcaktohen rrogat e personave të zgjedhur dhe të emëruar.

### Ndërprerja e funksionit dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit shtetëror

#### Neni 14

(1) Kryetari përkatësisht anëtarit të Komisionit shtetëror i pushon funksioni para skadimit të mandatit, në rastet në vijim:

- nëse jep dorëheqje,
- përgjithmonë e humb aftësinë për kryerje të funksionit, që e përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë,
- është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për veprë penale me dënim me burg pa lirim me kusht prej së paku gjashtë muaj ose
- ndodh vdekja e tij.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni e konstaton ndërprerjen e funksionit.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shkarkon kryetarin dhe anëtarin e Komisionit shtetëror me propozim të Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, nëse është plotësuar një prej kushteve në vijim:

- konstatohet se nuk i plotëson kushtet nga neni 11 i këtij ligji ose
- nëse refuzon të paraqesë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në pajtim me ligj ose nëse të dhënat e përmbajtura në deklaratë në masë të madhe janë të pavërteta ose
- në mënyrë evidente i shkel rregullat për konflikt të interesave, përkatësisht përjashtim në situata në të cilat anëtari ose kryetari ka ditur ose është dashur të dijë për ekzistimin e ndonjërs prej bazave për konflikt të interesave përkatësisht përjashtimit të parapara me ligj ose
- nëse pa shkaqe të arsyeshme nuk i respekton afatet për ndërmarrje të veprimeve të caktuara në pajtim me këtë ligj, ose
- mungon pa arsye nga puna e Komisionit më gjatë se gjashtë muaj.

(4) Për ekzistim të rasteve për ndërprerje të funksionit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për ekzistim të kushteve për shkarkim nga paragrafi (3) i këtij neni, kryetari i Komisionit shtetëror, ndërkaq në mungesë të tij zëvendëskryetari i Komisionit shtetëror, është i obliguar ta informojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në afat prej pesë ditëve nga kuptimi për ekzistim të rasteve përkatësisht kushteve.

(5) Kuvendi mund të veprojë në rastet nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni edhe pa marrje të njoftimit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Në rast të ndërprerjes së funksionit ose shkarkim të kryetarit të Komisionit shtetëror, deri në emërim të kryetarit të ri të Komisionit shtetëror, funksionin kryetar i Komisionit shtetëror e kryen zëvendëskryetari i Komisionit shtetëror, me të gjitha detyrat dhe autorizimet që ka pasur kryetari.

(7) Në rast të shkarkimit përkatësisht ndërprerjes së funksionit të kryetarit përkatësisht anëtarit të Komisionit shtetëror para skadimit të mandatit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni në afat prej dhjetë ditëve fillon procedurë për zgjedhje të kryetarit të ri përkatësisht anëtarit të ri të Komisionit shtetëror.

### Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror

#### Neni 15

(1) Kryetari i Komisionit Shtetëror e paraqet dhe përfaqëson Komisionin Shtetëror dhe e udhëheq dhe organizon punën e tij.

(2) Në rast të pengimit të kryetarit të Komisionit Shtetëror, Komisionin Shtetëror e paraqet dhe përfaqëson zëvendëskryetari i Komisionit Shtetëror, i zgjedhur në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Për punën e vet kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror përgjigjen para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 16

(1) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror, si dhe sekretari i përgjithshëm në Sekretariat, deklaratat për gjendjen pronësore dhe interesat e nenit 82 të këtij ligj i paraqesin në Komisionin Shtetëror në procedurë të njëjtë si dhe personat tjerë nga neni 82 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me afatet për dorëzimin, publikimin dhe procedurën për kontrollin e deklaratave për gjendjen pronësore dhe për interesat në mënyrë përkatëse kanë të bëjnë edhe me kryetarin, anëtarin e Komisionit Shtetëror dhe sekretarin e përgjithshëm në Sekretariat.

(3) Procedura për kontrollin e deklaratave për gjendjen pronësore dhe interesat e kryetarit, anëtarëve të Komisionit shtetëror dhe sekretarit të përgjithshëm në Sekretariatin e Komisionit shtetëror zbatohet çdo vit, më së voni deri 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraparak.

(4) Për rezultatet e procedurës së zbatuar nga paragrafi (3) i këtij neni Komisioni Shtetëror e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej dhjetë ditësh nga procedura e zbatuar.

(5) Komisioni për çështjen e zgjedhjeve dhe të emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për hulumtimin e gjendjes pronësore dhe interesave të kryetarit përkatësisht anëtarit të Komisionit Shtetëror ose sekretarit të përgjithshëm në Sekretariat, në rast të mosveprimit të tyre në pajtim me nenet 82 dhe 85 të këtij ligji, si dhe në rast të njohurive të marra përkatësisht dyshimeve për rritjen e pronës në mënyrë joproporcionale ose konflikt të interesave.

### Kompetenca

#### Neni 17

Komisioni Shtetëror i ka këto kompetenca:

1. miraton strategji nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, me planin aksional për zbatim;
2. zbaton kontroll kundër korrupsionit mbi ligje, akte nënligjore dhe akte tjera të përgjithshme, në pajtim me metodologjinë të cilën e miraton;
3. vepron pas kallëzimeve nga persona fizikë dhe juridikë për dyshime për korrupsion dhe konflikt të interesave;
4. ngre iniciativë para organeve kompetente për ngritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë së personave zyrtarë;
5. ngrit iniciativë për ngritjen e procedurës për ndjekje penale në lëndët për të cilat vepron;
6. e përcjell ligjshmërinë e financimit të partive politike;

7. e përcjell ligjshmërinë e financimit të fushatave zgjedhore;

8. ngre iniciativë para organeve kompetente në bazë të raporteve të Entit Shtetëror të Revizionit;

9. vepron në raste të konfliktit të interesave;

10. e evidenton dhe përcjellë gjendjen pronësore dhe interesat në procedurë në pajtim me këtë ligj;

11. përcakton formular të deklaratave për gjendjen pronësore dhe të interesave;

12. kryen kontroll të të dhënave nga deklaratat për gjendjen pronësore dhe interesat;

13. bashkëpunon me organe të tjera shtetërore në sigurimin e informatave të nevojshme;

14. bashkëpunon me trupa nacionalë të shteteve tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare në fushën e parandalimit të korrupsionit;

15. shkëmben informata me trupa kompetentë të shteteve tjera dhe organizatave ndërkombëtare, në bazë të obligimeve të ndërmarra me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë;

16. bashkëpunon me shoqata, fondacione, institucione shkencore dhe sektorin privat lidhur me preventivën e korrupsionit dhe konfliktit të interesave;

17. përgatit analiza për rreze të korrupsionit në sektor të ndryshëm;

18. ndërmer aktivitete në drejtim të përforsimit të integritetit personal dhe institucional;

19. ndërmer aktivitete të planit të edukimit dhe përforsimit të vetëdijes për korrupsion dhe konflikt të interesave;

20. mban regjistër për persona të zgjedhur dhe të emëruar;

21. mban regjistër të personave të autorizuar për pranimin e kërkesave të denoncuesve në pajtim me mbrojtjen e denoncuesve;

22. përgatit katalog të dhuratave në bazë të të dhënave të marra në pajtim me nenin 58 të këtij ligji dhe i publikon në ueb faqen e vet;

23. zbaton hulumtime të mendimit publik për vlerësimin e punës së vet dhe gjendjes me korrupsionin;

24. miraton program vjetor për punën e Komisionit Shtetëror;

25. miraton kod etik të Komisionit Shtetëror dhe të Sekretariatit;

26. miraton rregullore për punën e Komisionit Shtetëror;

27. miraton akte për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Sekretariat;

28. rregullisht e informon publikun për punën e vet lidhur me kompetencat që i ka në pajtim me këtë ligj dhe në pajtim me rregulloren e punës së Komisionit Shtetëror dhe

29. kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

### **Strategjia nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave**

#### **Neni 18**

(1) Komisioni Shtetëror miraton strategji pesëvjeçare nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave me planin aksional për zbatimin e saj (në tekstin e mëtejshëm: strategji nacionale).

(2) Komisioni shtetëror e përgatit strategjinë nacionale në bazë të analizës paraprakisht të përgatitur të rrezeve të korrupsionit.

(3) Strategjia nacionale dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për miratim.

(4) Komisioni shtetëror miraton metodologji për përgatitjen e strategjisë nacionale, para fillimit të procesit të përgatitjes së strategjisë nacionale.

(5) Strategjia nacionale përgatitet me pjesëmarrje të përfaqësuesve të organeve shtetërore, institucioneve, shoqërive, fondacioneve, sektorit privat dhe medie.

(6) Komisioni shtetëror e përcjell zbatimin e masave të strategjisë nacionale dhe përgatit raportet vjetore dhe raportet përfundimtar për zbatimin e strategjisë nacionale.

(7) Raportet nga paragrafi (6) të këtij neni Komisioni shtetëror i dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, më së voni deri 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(8) Komisioni Shtetëror miraton vendim për ndryshimin e strategjisë nacionale kur në bazë të analizave të zbatuara ose parashikimeve të raporteve vjetore për zbatimin e saj do të përcaktohet se kjo është e nevojshme. Ndryshimi i strategjisë nacionale përgatitet në procedurë të përcaktuar me paragrafin (5) të këtij neni dhe dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për miratim.

(9) Strategjia nacionale, ndryshimet e strategjisë nacionale, si dhe raportet nga paragrafi (6) i këtij neni, publikohen në ueb faqen e Komisionit Shtetëror.

### **Plani vjetor dhe raportit vjetor për punën e Komisionit Shtetëror**

#### **Neni 19**

(1) Komisioni shtetëror në tri vitet e fundit nga viti rrjedhës miraton plan vjetor për vitin e ardhshëm për kontrollin e financimit të partive politike dhe përcjelljen e gjendjes pronësore dhe konfliktit të interesave, duke zbatuar qasje të bazuar në vlerësimin e rrezikut të korrupsionit, me ç'rast është i obliguar që t'i marrë parasysh:

- të dhënat për identifikimin e rrezeve nga korrupsioni në pajtim me analizën e rrezikut nga korrupsioni nga neni 17 paragrafi 1 pika 17 e këtij ligji,

- të dhëna për rrezikun e kategorive të veçanta të subjekteve, subjekteve të veçanta dhe të dhëna të tjera të arritshme për subjektet e të ngjashme.

(2) Komisioni shtetëror për punën e vet dorëzon raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak. Raportin vjetor Komisioni shtetëror e dorëzon edhe te Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe mjetet e informimit publik.

(3) Raporti vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni në veçanti përmban:

- të dhëna statistikore për lëndë të formuara, lëndë të zgjidhura dhe lëndë për të cilat vepron në pajtim me kompetencat e veta, me analizë,

- numrin e iniciativave të paraqitura në prokurorinë publike dhe organet të tjera,

- informatë për institucionet të cilat kanë vepruar për kërkesat e Komisionit shtetëror,

- numrin e lëndëve për të cilat është ngritur procedurë kundërvajtëse,

- vlerësim të zbatimit të këtij ligji dhe

- vlerësim të gjendjes me korrupsionin dhe luftën kundër korrupsionit në shtet.

(4) Me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Komisioni shtetëror është i obliguar të parashtojë raport edhe për periudhë më të shkurtër se një vit.

(5) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i shqyrton dhe miraton raportet nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni.

### **Sekretariati i Komisionit Shtetëror**

#### Neni 20

(1) Sekretari i përgjithshëm dhe të punësuarit në Sekretariat kanë status të nëpunësve administrativë.

(2) Sekretarin e përgjithshëm e zgjedh Komisioni shtetëror me shumicë votash nga përbërja e plotë e Komisionit shtetëror.

(3) Për çështje të cilat kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës të të punësuarve në paragrafin (1) të këtij neni, zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë, dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune dhe ky ligj.

(4) Sekretariati siguron zbatim të papenguar të kompetencave të Komisionit shtetëror me kryerje të punëve administrative në kompetencë të Komisionit shtetëror, duke përfshirë edhe ndjekjen e gjendjes pronësore dhe interesave, ndjekjen e ligjshmërisë së financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, zbatimin e kontrolleve, thirrjen e personave dhe dhënien e mendimeve, propozimeve dhe rekomandimeve në kompetencë të Komisionit shtetëror në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përgjigjeve për kërkesa për qasje të informatat, në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik, e pas lëndëve dhe parashtrësive të pranura zbaton kontroll administrativ dhe me rezultatet nga kontrolli detyrimisht ia kalon Komisionit shtetëror përkatësisht organeve kompetente për veprim të mëtejshëm.

(5) Të punësuarit në sekretariat në Komisionin shtetëror kanë të drejtë shtese të rrogës për:

- kushte të veçanta të punës,
- ekzistim të rrezikut të lartë dhe
- besueshmëri.

(6) Shtesat e rrogës nga paragrafi (5) i këtij neni nuk përjashtohen ndërmjet veti.

(7) Shuma e përgjithshme e shtesave të rrogës nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se 30% nga rroga themelore e të punësuarit.

### **Buxheti i Komisionit shtetëror**

#### Neni 21

(1) Mjetet për kryerjen e funksionit të Komisionit shtetëror sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Për sigurimin e mjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni shtetëror përpilon propozim që e dorëzon të Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për buxhetet.

(3) Kryetari i Komisionit shtetëror, e në mungesë të tij zëvendës-kryetari i Komisionit shtetëror, merr pjesë në mbledhjet e trupave punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që t'i prezantojnë dhe arsyetojnë nevojat për mjetet e paragrafit (1) të këtij neni.

### **Kapitulli i tretë**

#### **MËNYRA E VENDIMARRJES E KOMISIONIT SHTETËROR**

#### **Mbledhjet e komisionit**

##### Neni 22

(1) Komisioni shtetëror, vendimet në kryerjen e punëve të kompetencave të veta, i miraton në mbledhje me të cilën kryeson kryetari i Komisionit shtetëror, me shumicën e votave nga përbërja e plotë e Komisionit shtetëror.

(2) Me Rregulloren për punë përcaktohet mënyra e punës së Komisionit shtetëror.

(3) Mbledhjet e Komisionit shtetëror janë publike.

(4) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, publiku mund të përjashtohet kur vepohet për lëndë të cilat përmbajnë informata të klasifikuara dhe të dhëna të cilat janë të mbrojtura me ligj.

(5) Për shqyrtimin e çështjeve të caktuara Komisioni shtetëror mund të kërkojë mendim nga persona profesionistë ose të thirr persona profesionistë të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit shtetëror.

(6) Vendimet në kompetencë të vet për lëndët për të cilat ka filluar procedura Komisioni shtetëror i miraton në afat prej 60 ditëve nga dita e fillimit të procedurës, përveç nëse me këtë ligj është e rregulluar ndryshe.

(7) Vendimet e Komisionit shtetëror detyrimisht duhet të përmbajnë arsyetim dhe publikohen në ueb faqen e tij në afat prej pesë ditëve nga dita e miratimit të tyre.

#### **Veprimi i Komisionit Shtetëror**

##### Neni 23

(1) Komisioni Shtetëror vepron me vetiniciativë ose në bazë të denoncimeve të marra.

(2) Për përcaktim të plotë të gjendjes faktike, Komisioni Shtetëror mund të kërkojë të dhëna dhe informata nga institucione kompetente, persona juridikë dhe fizikë.

(3) Personi përgjegjës në institucionin kompetent ose personi i autorizuar prej tij i merr të gjitha masat dhe aktivitetet për dorëzimin e informatave të kërkuara dhe të njëjtat i dorëzon më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës nga Komisioni Shtetëror.

(4) Në rast të mosveprimit pas kërkesës nga ana e institucionit kompetent në afatin e përcaktuar me paragrafin (3) të këtij neni, Komisioni shtetëror dorëzon kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

#### **Procedura pas vendimit të Komisionit shtetëror për shkeljen e dispozitave të Ligjit**

##### Neni 24

(1) Për shkelje të konstatuar të dispozitave të këtij ligji Komisioni shtetëror e informon organin në të cilin personi zyrtar kryen autorizime publike dhe organin kompetent për zgjedhje, emërimi, të personit zyrtar.

(2) Organi kompetent, është i obliguar pas njoftimit të Komisionit Shtetëror për shkeljen e konstatuar të paragrafit (1) të këtij neni, me shkrim ta informojë Komisionin Shtetëror për masat e ndërmarra në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, përveç nëse ndryshe nuk është rregulluar me këtë ligj.

(3) Komisioni Shtetëror ngre edhe procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente nëse janë shkelur dispozitat e këtij ligji.

### **Kërkimet e të dhënave nga bankat dhe institucione të tjera financiare dhe qasja në bazat e të dhënave**

Neni 25

(1) Pas procedurës së ngritur Komisioni Shtetëror mund të kërkojë të dhëna nga bankat dhe institucionet tjera financiare, për çfarë menjëherë e informon personin zyrtar për të cilin kërkohen të dhëna, përkatësisht personin përgjegjës në personin juridik për të cilin kërkohen të dhëna.

(2) Bankat dhe institucionet tjera financiare janë të obliguara në afat prej 15 ditësh në Komisionin Shtetëror t'i dorëzojnë të dhënat e kërkuara nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Dorëzimi i të dhënave të kërkuara nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk paraqet shkelje të sekretit bankar.

(4) Në kryerjen e kompetencave të veta Komisioni Shtetëror ka qasje në bazat e të dhënave të cilat udhëhiqen në organe tjera dhe institucione, me ç'rast ka qasje direkte elektronike dhe shfrytëzon të dhëna nga bazat e të dhënave, pa kompensim nga:

1. Ministria e Punëve të Brendshme:

- të dhëna nga evidenca e numrit të amzës,
- të dhëna nga regjistri i shtetasve të Republikës së Maqedonisë,
- të dhëna nga regjistri i letërnjoftimeve të lëshuara,
- të dhëna nga evidenca e lejeve për furnizim të armës së koleksionit.
- të dhëna nga evidenca e lejeve për armë të koleksionit.
- të dhëna nga evidenca e koleksionistëve,
- të dhëna nga evidenca për armë të konfiskuar, të gjetur, të dorëzuar dhe municion,
- të dhëna nga evidenca për automjete motorike të regjistruara (lista e automjeteve në pronësi të personit fizik dhe juridik, lista e pronarëve të automjeteve motorike),
- të dhëna nga evidenca për objekte lundrimi të regjistruara,
- të dhëna nga regjistri i ekonomive familjare etj.

2. Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë:

- të dhëna nga evidenca për persona të siguruar në pajtim me dispozitat për sigurim pensional dhe invalidor dhe status,
- të dhëna nga evidenca për pensionist dhe status të pensionistit.

3. Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë:

- të dhëna nga evidenca e personave të siguruar në pajtim me dispozitat për sigurim të detyrueshëm shëndetësor.

4. Drejtoria e të Hyrave Publike:

- të dhëna nga evidenca për NUAS dhe NUT,
- të dhëna nga evidenca të regjistrat tatimor,
- të dhëna nga evidenca për të hyra nga fletëparaqitjet vjetore tatimore për persona fizikë për tatim personal mbi të ardhurat,
- të dhëna nga evidenca për fletëparaqitje mujore tatimore lidhur me TVSH-në,
- të dhëna nga evidenca për kthim të më shumë ose tatimit të arkëtuar gabimisht,

- të dhëna nga evidenca për kthimin e TVSH,
- të dhëna nga evidenca për kontrollet e zbatuara tatimore dhe hetime,
- të dhëna nga evidenca për veprimtari të regjistruara të cilat kryejnë pagesa me para në dorë,
- të dhëna nga evidenca për kontabilistë të autorizuar të personave juridikë.

5. Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë:

- të dhëna nga evidenca e personave të punësuar (historikisht M1/M2 formular, të punësuar në firmë të caktuar,
- të dhëna nga evidenca e personave të papunësuar dhe personave të tjerë të cilët kërkojnë punë,
- të dhëna nga evidenca e shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi të punësuar në Republikën e Maqedonisë.

6. Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive:

- të dhëna nga regjistri i njësjive hapësinore,
  - të dhëna nga evidenca e aktzotërimeve,
  - të dhëna nga regjistri i çmimeve dhe qirave,
  - të dhëna për lëvizjen e pronësisë së pronës.
7. Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë SHA Shkup:
- të dhëna nga regjistri i letrave me vlerë,
  - të dhëna nga regjistri i pronarëve të letrave me vlerë,
  - të dhëna nga regjistri për barazimet e transaksioneve tregtare,

8. Të dhëna nga regjistri për bartje jotregtare të letrave me vlerë,

- të dhëna nga regjistri i letrave me vlerë të huazuara,
8. Të dhëna nga regjistri unik i llogarive të transaksionit – Shtëpia e Kliringut "KIBS" SHA Shkup:
- të dhëna nga regjistri i llogarive të transaksionit.

9. Të dhëna nga Byroja Kreditore:

- të dhëna nga portali MOJ.MKB.MK
10. Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë:
- të dhëna nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave të tjerë juridikë,

- të dhëna nga regjistri i llogarive vjetore,
- të dhëna nga regjistri i pengut,
- të dhëna nga regjistri për lizing,
- të dhëna nga regjistri i investimeve në patundshmëri,
- të dhëna nga regjistri i të drejtave mbi patundshmëri,
- të dhëna nga regjistri për investime të drejtpërdrejta të rezidentëve në vende të huaja,
- të dhëna nga regjistri i investimeve të drejtpërdrejta të jorezidentëve në Republikën e Maqedonisë,

- të dhëna nga regjistri për sigurimin e bartjes së pronësisë së lëndëve dhe bartje të të drejtave (regjistri fiduciar),

- të dhëna nga regjistri për shitjen e sendeve të tundshme me mbajtjen e të drejtës së pronësisë.

11. Drejtoria Doganore:

- të dhëna nga evidenca për deklarata doganore të personit fizik,
- të dhëna nga evidenca për deklarata doganore të personit juridik,
- të dhëna nga evidenca për importin e kryer dhe për eksportin e realizuar,
- të dhëna nga regjistri i obligacioneve për akciza,
- të dhëna nga evidenca për dokumentin unik doganor,
- të dhëna nga evidenca për para të huaja të futura, nxjerra dhe letra me vlerë,

12. Ministria e Drejtësisë – Drejtoria për Udhëheqjen e Librave të Amzës:



- të dhëna nga librat e amzës për të lindurit,
- të dhëna nga librat e amzës për të kurorëzuarit,
- të dhëna nga librat e amzës për të vdekurit,
- të dhëna nga evidencat për prindër/ kujdestar për person të caktuar,

- të dhëna nga evidenca për farefisni ndërmjet personave.

13. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale:

- të dhëna nga evidenca për persona shfrytëzues të ndihmës sociale.

14. Enti Shtetëror i Revizionit:

- të dhëna nga evidenca për revizione të kryera,
- të dhëna nga sistemi elektronik për menaxhim me revizionin.

15. Bursa Maqedonase e Letrave me Vlerë:

- të dhëna nga evidencat e përmbajtur në MB NET,
- të dhëna nga evidenca për transaksione të lidhura, duke përfshirë edhe bllok transaksionet.

16. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë:

- të dhëna nga evidencat nga qarkullimi pagesor me vende të huaja.

17. Ministria e Ekonomisë

- të dhëna nga regjistri i marrëveshjeve të lidhura për koncesione.

(5) Kryetari, anëtarët dhe të punësuarit në Komisionin Shtetëror që do të kenë qasje të bazat e të dhënave nga paragrafi (4) të këtij neni janë të obliguar që t'i ruajnë, mund t'i shfrytëzojnë ekskluzivisht për qëllimet për të cilat janë marrë dhe nuk guxojnë t'ua zbulojnë personave të tretë, në kundërshtim me ligjin.

### Thirrja e personave

Neni 26

(1) Për procedurën e ngritur për sqarimin e çështjeve të caktuara lidhur me miratimin e vendimit nga kompetenca e vet, Komisioni Shtetëror mund ta ftojë personin për të cilin mbahet procedura.

(2) Personi mund t'i përgjigjet kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni personalisht ose me shkresë në Komisionin Shtetëror.

(3) Nëse personat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i përgjigjen kërkesës nga ftesa e Komisionit Shtetëror, Komisioni Shtetëror në bazë të provave tjera me të cilat disponon e shqyrton rastin për të cilin mbahet procedura.

(4) Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni është konfidenciale.

### Kryerja e këqyrjes në dokumentacionin e institucioneve publike dhe personave të tjerë juridikë

Neni 27

Në kryerjen e punëve në kompetencë të vet të përcaktuara me këtë ligj, Komisioni Shtetëror mund të kërkojë të kryejë këqyrje të drejtpërdrejtë në dokumentacionin e institucioneve publike dhe personave të tjerë juridikë.

### Përdorimi i ekspertëve të jashtëm

Neni 28

(1) Gjatë kryerjes së detyrave të veta dhe kompetencave, Komisioni Shtetëror mund të përdorë ekspertizë të jashtme.

(2) Personi fizik ose juridik i cili është i obliguar për ekspertizën nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon të zbulojë, publikojë ose t'i ndajë me persona të tretë të dhënat ose informatat të cilat i ka marrë ose me të cilat janë njoftuar në kuadër ose lidhur me kryerjen e punës së vet.

(3) Ekspertiza e përgatitur për nevojat e Komisionit Shtetëror është pronë e tij dhe mund të publikohet në ueb faqen e Komisionit Shtetëror ose në mënyrë tjetër t'i dorëzohet publikut vetëm nga ana e Komisionit Shtetëror.

Neni 29

(1) Organet kompetente të të cilat janë ngritur iniciativa nga neni 17, alinetë 4, 5 dhe 8 të këtij ligji janë të obliguar në afat prej 60 ditëve ta informojnë Komisionin Shtetëror për vendimet e marra në raport me të njëjtat.

(2) Me kërkesë të Komisionit Shtetëror, organet kompetente nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar në afat sa më të shkurtër të japin informatë për rrjedhën e veprimtimit pas iniciativave të cilat i ka ngritur.

### Bashkëpunimi me shoqata dhe fondacione, institucione shkencore dhe sektorin privat

Neni 30

Në kuadër të realizimit të aktiviteteve të veta programore të cilat përfshijnë hulumtime, analiza, trajnime, informim dhe ngritje të vetëdijes së publikut dhe të institucioneve të sektorit publik dhe bartjes së praktikave të mira, Komisioni Shtetëror mund të bashkëpunojë me shoqëri dhe fondacione, institucione shkencore dhe sektorin privat, në sferën e parandalimit të korrupsionit.

### Kapitulli i katërt

#### PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË POLITIKË

#### Përcjellja e ligjshmërisë së financimit të partive politike

Neni 31

(1) Në rast të ekzistimit të dyshimit për financim joligjor të partisë politike, Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose me iniciativë nga organe shtetërore, parti politike ose shoqata dhe fondacione që punojnë në sferën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të së drejtës ose menaxhimit të mirë, mund të miratojë aktvendim për fillimin e procedurës për hulumtimin e financimit të partisë politike.

(2) Komisioni Shtetëror e dorëzon iniciativën dhe aktvendimin për fillimin e procedurës te partia politike financimin e të cilës e hulumton me thirrje që të prononcohet për konstatimet në iniciativë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të saj në partinë politike.

(3) Komisioni Shtetëror është i obliguar në afat prej 60 ditësh ta kryejë procedurën, ta informojë personin i cili ka ngritur iniciativë për hulumtimin dhe financimin e partive politike dhe ta informojë publikun për konstatimet nga procedura e ngritur.

(4) Nëse përcaktohet se dyshimi nga paragrafi (1) i këtij neni është i bazuar, Komisioni Shtetëror inicion procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente.

(5) Partitë politike e kanë për detyrë te Komisioni Shtetëror t'i dorëzojnë raportet për financim në afatin e përcaktuar në Ligjin për financim të partive politike.

(6) Partitë politike e kanë për detyrë të dorëzojnë edhe të dhëna të tjera me kërkesë të Komisionit Shtetëror për shkak të zbatimit të kompetencës së tij për mbajtjen e procedurës për ndjekjen e ligjshmërisë së financimit të partive politike.

#### **Ndjekja e ligjshmërisë së financimit të fushatave zgjedhore**

##### **Neni 32**

(1) Në rast të ekzistimit të dyshimit për financim joligjor të fushatës zgjedhore, Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose me kundërshtim nga organizatori i fushatës zgjedhore ose vëzhguesit e akredituar, ngre procedurë për përcaktimin e gjendjes faktike.

(2) Komisioni Shtetëror kundërshtimin nga paragrafi (1) i këtij neni e dorëzon te personi kundër të cilit është parashtruar, në afat prej 24 orësh nga pranimi i kundërshtimit.

(3) Personi nga paragrafi (2) i këtij neni mund të prononcohet për konstatimet në kundërshtimin në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të tij.

(4) Komisioni Shtetëror e ka për detyrë në mbledhje publike në afat jo më të gjatë se pesë ditë nga dita e pranimit të kundërshtimit t'i analizojë konstatimet dhe të veprojë për kundërshtimin.

(5) Komisioni Shtetëror vendos për kundërshtimet në mbledhje publike dhe e ka për detyrë në afat prej 24 orësh nga dita e caktimit të mbledhjes publike, vendimin ta publikojë në faqen e vet të internetit. Në mbledhjen publike thirret dhe ka të drejtë të marrë pjesë parashtruesi i kundërshtimit, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i organizatorit të fushatës kundër të cilit është parashtruar kundërshtimi.

(6) Kundër vendimit nga paragrafi (5) të këtij neni lejohet padia te Gjykata Administrative në afat prej 24 orësh nga marrja e vendimit. Gjykata Administrative e ka për detyrë të miratojë vendim në afat prej 48 orësh nga pranimi i padisë.

(7) Nëse përcaktohet se dyshimet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të bazuara, Komisioni Shtetëror ka për detyrë të iniciojë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente në afat prej 15 ditësh nga vendimi i miratuar.

(8) Organizatorët e fushatës zgjedhore kanë për detyrë te Komisioni Shtetëror t'i dorëzojnë raportet për financimin e fushatës zgjedhore në afatin e përcaktuar me Kodin zgjedhor.

(9) Organizatorët e fushatave zgjedhore kanë për detyrë të dorëzojnë edhe të dhëna të tjera me kërkesë të Komisionit Shtetëror për shkak të zbatimit të kompetencës së tij për ndjekjen e ligjshmërisë së financimit të fushatave zgjedhore.

(10) Komisioni Shtetëror, më së voni në afat prej tre muajsh nga dita e përfundimit të zgjedhjeve te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dorëzon në shqyrtim raport të veçantë për gjendjet e përcaktuara në financimin e fushatës zgjedhore. Raporti publikohet edhe në ueb faqen e Komisionit Shtetëror.

#### **Kontrolli për keqpërdorim të mjeteve buxhetore në periudhën pas shpalljes së zgjedhjeve**

##### **Neni 33**

(1) Komisioni Shtetëror është kompetent ta ndjekë ligjshmërinë e shfrytëzimit, përkatësisht disponimit me mjetet buxhetore nga dita e shpalljes deri në përfundimin e zgjedhjeve.

(2) Në rast të ekzistimit të dyshimit për shkelje të dispozitave nga Kodi Zgjedhor për ndalim të përdorimit të mjeteve buxhetore, përkatësisht veprime të ndaluarat të institucioneve publike nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, si dhe shkelje të dispozitave të këtij ligji që rregullojnë veprim të ndaluar nga çasti i miratimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror me vetiniciativë ose pas kundërshtimit të parashtruar nga organizatori i fushatës zgjedhore, hap procedurë për konstatimin e gjendjes faktike.

(3) Komisioni Shtetëror kundërshtimin nga paragrafi (1) i këtij neni e dorëzon te personi kundër të cilit është parashtruar në afat prej 24 orësh nga pranimi i kundërshtimit. Personi mund të deklarohet për konstatimet në kundërshtimin, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kundërshtimit.

(4) Komisioni Shtetëror është i detyruar që në mbledhje publike në afat jo më gjatë se pesë ditë nga dita e pranimit të kundërshtimit t'i analizojë konstatimet dhe të veprojë për kundërshtimin.

(5) Komisioni Shtetëror vendos për kundërshtimet në mbledhje publike dhe është i detyruar që në afat prej 24 orësh nga mbledhja e caktuar publike, vendimin ta publikojë në ueb faqen e vet. Në mbledhjen publike thirret dhe ka të drejtë të jetë i pranishëm parashtruesi i kundërshtimit, si dhe përfaqësuesi i autorizuar i institucionit publik kundër të cilit është parashtruar kundërshtimi.

(6) Kundër vendimit nga paragrafi (5) i këtij neni lejohet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orësh nga marrja e vendimit. Gjykata Administrative është e detyruar që të miratojë vendim në afat prej 48 orësh nga pranimi i padisë.

(7) Nëse konstatohet se dyshimet nga paragrafi (2) i këtij neni janë të bazuara, Komisioni Shtetëror është i detyruar që të iniciojë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

#### **Ndalimi për investime të reja dhe pagesa të jashtëzakonshme**

##### **Neni 34**

Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë, deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të komunës ose të anëtarëve të këshillit respektivisht konstituimit të këshillit të komunave dhe të qytetit të Shkupit, nuk mund:

- të fillojë ndërtimin me mjete nga buxheti ose nga fonde publike, ose me mjete të ndërmarrjeve publike ose personave tjerë juridikë që disponojnë kapital shtetëror për

objekte të reja të infrastrukturës, si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim dhe objekte tjera, ose të objekteve për veprimtari shoqërore- shkolla, çerdhe dhe objekte tjera, përveç nëse për këtë qëllim janë siguruar mjete paraprakisht nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizimin e programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin rrjedhës,

- të kryhen pagesa të rrogave, pensione, ndihmës sociale ose të pagesave tjera dhe kompensimeve materiale nga mjetet buxhetore ose nga mjetet nga fondet publike që nuk janë pagesa të rregullta mujore, respektivisht të gjitha transferet njëvjeçare dhe pagesa ose transferimet të njëhershme nga mjetet buxhetore ose nga mjetet të fondeve publike, as të tjetërsojë kapital shtetëror, as të nënshkruajë marrëveshje kolektive,

- të fillohet procedurë për punësimin e personave të rinj ose procedurë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në institucionet shtetërore dhe publike, kurse procedurat e filluara vihen në pezullim, përveç në raste të çështjeve urgjente dhe të paprolongueshme.

#### **Ndalimi për shfrytëzimin e burimeve të kundërligjshme dhe anonime të financimit gjatë zgjedhjeve**

##### **Neni 35**

(1) Partia politike ose kandidati në zgjedhje nuk guxojnë të mbledhin dhe shfrytëzojnë mjete të kundërligjshme ose nga burime anonime.

(2) Nëse paraqitet dyshim se partia politike ose kandidati në zgjedhje ka përdorur mjete në mënyrë të paligjshme ose nga burime anonime, Komisioni Shtetëror do të kërkojë nga organet kompetente të kryejnë kontroll të burimit të mjeteve dhe të ai të dorëzojnë raport të hollësishëm për shfrytëzimin e mjeteve.

(3) Kontrollimi i hyrjes së mjeteve ose pagesa tjera përmes bankës, me kërkesë të Komisionit Shtetëror, nuk paraqet shkelje të sekretit bankar.

(4) Nëse konstatohen se dyshimet nga paragrafi (2) të këtij neni janë të bazuara, Komisioni Shtetëror në afat prej shtatë ditëve nga dita e përcaktimit të dyshimit të bazuar, inicon procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë para organeve kompetente.

#### **Përcaktimi i keqpërdorimit të financimit të partisë politike gjatë kohës së fushatës zgjedhore**

##### **Neni 36**

(1) Kur ekzistojnë baza për dyshim se mjetet buxhetore, mjetet nga fondet publike ose ndërmarrjet publike dhe institucionet publike ose subjektet tjera juridike që disponojnë me kapital shtetëror, janë drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes punëve investuese ose në mënyra tjera, të shfrytëzuara për fushata zgjedhore ose në përgjithësi për financimin e zgjedhjeve dhe veprimtarive të tjera politike, Komisioni Shtetëror ndërmerr masa për konstatimin e dyshimeve të tilla.

(2) Nëse Komisioni Shtetëror konstaton se dyshimet nga paragrafi (1) të këtij neni janë të bazuara, për atë pa prolongim do t'i njoftojë organet kompetente dhe do të kërkojë nga ato të ndërmarrin aktivitete në suaza të kompetencave të tyre.

(3) Komisioni shtetëror më së voni në afat prej tre muajve nga dita e mbarimit të zgjedhjeve i dorëzon raport të veçantë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për

keqpërdorimet e konstatuara në financimin e fushatës zgjedhore. Raporti publikohet në mjetet për informim publik.

#### **Dhënia rryshfet zgjedhësve**

##### **Neni 37**

(1) Nëse Komisioni Shtetëror kupton ose ka baza për dyshim për rryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, respektivisht për dhënien ose premtimin e dhuratës, ose ndonjë përfitim tjetër për vete ose për tjetër, zgjedhësit gjatë zgjedhjeve ose votimit në referendum, që të votojë ose të mos votojë, ose të votojë për kandidat të caktuar ose vendim të caktuar, për atë pa prolongim do ta njoftojë prokurorin publik kompetent.

(2) Prokurori publik në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (2) të këtij neni e njofton Komisionin Shtetëror për masat e marra dhe aktivitetet në suaza të kompetencave të veta.

#### **Privilegj ose diskriminim në furnizimet publike dhe marrëveshje tjera**

##### **Neni 38**

(1) Komisioni Shtetëror mund të kryejë këqyrje në dokumentacionin për furnizim publik dhe për marrëveshje të lidhura me realizimin e profitit të lidhura ndërmjet organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë që disponojnë me kapital shtetëror me personat juridikë vendas ose të huaj, si dhe të gjitha lejet, koncesionet dhe vendimet tjera me të cilat personave juridikë u njihet e drejta ose privilegjet e përcaktuara me ligj ose i merren ose kufizohen të drejtat e tilla ose volitshmëritë.

(2) Nëse Komisioni Shtetëror përcakton privilegje ose diskriminim në lidhje me marrëveshjet për furnizime publike dhe marrëveshjet e tjera nga paragrafi (1) të këtij neni, pa prolongim do të kërkojë nga organet kompetente të ndërmarrin masa dhe aktivitetet në suaza të kompetencave të tyre.

#### **Ndikimi gjatë zgjedhjes, emërimeve dhe shkarkimit në vende udhëheqëse**

##### **Neni 39**

(1) Partia politike ose personi që vepron në emër të partisë politike nuk guxon të kryejë presion gjatë zgjedhjes ose emërimit, ose shkarkimit të personit në funksion zyrtar, udhëheqës, ose funksion tjetër ose detyrë, përveç rasteve në të cilat me ligj është përcaktuar kompetenca e Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ose organet e njësive të vetëqeverisjes lokale të kryejnë zgjedhje, emërim ose të japin mendim ose pajtim.

(2) Personi i cili është shkarkuar në kundërshtim me ligjin nën presion të partisë politike, si dhe kandidati për zgjedhje ose emërim që është dëmtuar me zgjedhje ose emërim të bërë nën presion të tillë, mund para gjykatës kompetente me padi të kërkojë anulimin e aktit për zgjedhje, emërim, respektivisht shkarkim.

(3) Padija nga paragrafi (2) të këtij neni parashtrohet në afat prej 30 ditëve nga miratimi i aktit për zgjedhje, emërim ose shkarkim, përkatësisht nga momenti i kuptimit se kjo është kryer nën presionin të partisë politike, në

kundërshtim me ligjin, por jo pas kalimit të një viti nga dita e miratimit të aktit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

#### Neni 40

(1) Partia politike ose personi që vepron në emër të partisë politike nuk guxon të kryejë ndikim në punësimin, sistemim ose ndërprerje të marrëdhënies së punës të personit zyrtar.

(2) Komisioni Shtetëror mund nga organi kompetent të kërkojë rishqyrtim ose anulim të vendimit të marrë në kundërshtim të paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Organi që e ka miratuar vendimin nga paragrafi (1) të këtij neni është i obliguar të veprojë sipas kërkesës së Komisionit Shtetëror në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

#### Neni 41

Informata e cila është përcaktuar me shkallën e klasifikimit nuk do të konsiderohet si informacion i klasifikuar nëse me atë fshihet korrupsion ose ndonjë veprë tjetër e dënueshme ose akt nënligjor ose procedurë, në përputhje me dispozitat e ligjit për informacione të klasifikuara.

#### Mbrojtja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe dëshmitarëve

#### Neni 42

(1) Nuk mund të ndërmerret ndjekje ndëshkuese ose të thirrret në çfarëdo përgjegjësie tjetër personi që ka zbuluar të dhëna që sugjerojnë për ekzistim të korrupsionit.

(2) Personi që ka dhënë deklaratë ose ka dëshmuar në procedurë për veprë korruptuese i sigurohet mbrojtje në pajtim me ligjin. Personi ka të drejtë në kompensim të dëmit që mund ta pësojë ai ose anëtar i familjes së tij për shkak të deklaratës së dhënë ose dëshmisë.

(3) Kërkesa për kompensim të dëmit nga paragrafi (2) të këtij neni parashtrohet deri te organi kompetent.

#### Mbrojtja e personave që punojnë në parandalimin e korrupsionit

#### Neni 43

(1) Personat që punojnë në organet për zbulim dhe mpohje të korrupsionit i sigurohet mbrojtje e plotë dhe pavarësi, për shkak të kryerjes efikase të autorizimeve të tyre dhe detyrave dhe mbi to nuk mund të kryhet presion në punë ose në marrjen e veprimeve konkrete.

(2) Personave të autorizuar për pranim të kallëzimeve nga denoncuesit u sigurohet mbrojtje e plotë dhe pavarësi, për shkak të kryerjes efikase të autorizimeve të tyre dhe detyrave dhe mbi to nuk mund të kryhet presion në punë ose në marrjen e veprimeve konkrete.

(3) Për presionin e kryer në punë ose në marrjen e veprimeve konkrete, personat nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni e njoftojnë Komisionin Shtetëror.

(4) Për presion të kryer në punë ose marrjen e veprimeve konkrete mbi anëtarët e Komisionit Shtetëror, Komisioni Shtetëror menjëherë e njofton Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

## Kapitulli i pestë

### PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË KRYERJEN E AUTORIZIMEVE PUBLIKE

#### Ndalea për kryerjen e veprimtarive tjera

#### Neni 44

(1) Personi i zgjedhur ose i emëruar gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij detyrohet t'i respektojë rregullat për mospërputhje të funksionit që e kryen me funksione tjera ose veprimtari të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje.

(2) Funksioni president i Republikës, kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministër, deputet, anëtar i këshillit, kryetar komune, gjykatës, prokuror publik, avokat i popullit, dhe funksione tjera të cilët i zgjedh ose emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale janë të papërputhshme njëra me tjetrën.

(3) Personave të zgjedhur dhe të emëruar funksionet e të cilëve kryhen në mënyrë profesionale, marrëdhënia e punës u pezullohet në pajtim me ligjin.

(4) Personi i zgjedhur ose i emëruar nuk mund të kryejë njëkohësisht funksion të personit përgjegjës ose anëtar të organit menaxhues ose organit mbikëqyrës në ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror.

(5) Personi i zgjedhur ose i emëruar dhe personi përgjegjës në ndërmarrje publike ose person tjetër juridik me kapital shtetëror dominues nuk mund të kryejë funksionin anëtar i bordit drejtues ose të ndonjë organi tjetër drejtues në shoqëri tregtare ose person tjetër juridik që merret me veprimtari me të cilën realizohet profit.

(6) Personi zyrtar mund të realizojë të hyra nga aktivitete shkencore, mësimore, kulturore, artistike dhe sportive dhe të hyra nga të drejta autoriale, patenta dhe të drejta të përafërta, pronësisë intelektuale dhe industriale, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(7) Personit zyrtar i cili është i punësuar në administratën shtetërore ose në administratën lokale, nëse zgjidhet si anëtar i këshillit komunal, përkatësisht të Qytetit të Shkupit, marrëdhënia e punës i pezullohet në pajtim me ligjin, me ditën e verifikimit të mandatit të anëtarit të këshillit.

#### Kufizime për kryerjen e veprimtarisë gjatë ushtrimit të funksionit

#### Neni 45

(1) Personi i cili e merr funksionin e personit të zgjedhur ose të emëruar, me përjashtim të personave që e marrin funksionin që nuk kryhet profesionalisht, nëse menaxhon me shoqëri tregtare ose institucion si pronar, është i obliguar para se ta marrë funksionin menaxhimin t'ia besojë personit tjetër ose organit tjetër, përveç anëtarëve të familjes së tij, gjatë kohës së kryerjes së funksionit, autorizimeve publike ose detyrave .

(2) Çdo person i zgjedhur ose i emëruar, person përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së funksionit deri te institucioni respektivisht organi në të cilin e kryen funksionin i paraqet personat juridikë në pronësi të tij, në të cilat ka aksione ose pjesëmarrje ose funksion menaxhues.

(3) Organi nga paragrafi (2) të këtij neni është i detyruar këto të dhëna publikisht t'i shpallë.

(4) Në rast kur në shoqërinë tregtare ose në subjektin tjetër nga paragrafi 1 i këtij neni, është formuar organ i menaxhimit, në të cilin personi i zgjedhur ose i emëruar, si anëtar i atij organi, i kryen të drejtat menaxhuese, bartja e të drejtave menaxhuese nënkupton obligim për personin e zgjedhur ose të emëruar të paraqesë dorëheqje në anëtarësinë në organin e menaxhimit, në pajtim me ligj.

(5) Personi i zgjedhur ose i emëruar detyrohet, në afat prej 30 ditësh nga bartja e të drejtave menaxhuese, Komisionit shtetëror t'ia dorëzojë të dhënat për personin të cilit ia ka bartur të drejtat menaxhuese dhe dëshmi për bartjen e të drejtave menaxhuese. Personi të cilit personi i zgjedhur ose i emëruar ia ka bartur të drejtat menaxhuese konsiderohet si person me të cilin personi zyrtar ka interes privat, në pajtim me nenin 8 paragrafi (4) të këtij ligji.

### Kufizimi i kryerjes së mbikëqyrjes

Neni 46

Personat të cilët me personin zyrtar janë të afërt, për të cilët në mënyrë të arsyeshme konsiderohet se ekziston interes që i lidh me personin zyrtar, nuk mund të kryejnë mbikëqyrje superrevizore ose kontrolluese në punën e tij.

### Kufizimi i kryerjes së veprimtarisë pas ndërprerjes së funksionit

Neni 47

(1) Personi zyrtar në afat prej tre viteve pas përfundimit të kryerjes së autorizimeve ose detyrave publike, nuk mund të:

- të punësohet në shoqërinë tregtare në të cilën ka kryer mbikëqyrje ose ka pasur çfarëdo marrëdhënie kontraktuese gjatë kryerjes së autorizimeve se detyrave publike,
- të fitojë në çfarëdo baze aksione ose pjesëmarrje në personin juridik në të cilin ka punuar, respektivisht ka kryer mbikëqyrje.

(2) Personi zyrtar në afat prej dy viteve pas përfundimit të kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave publike, respektivisht pas ndërprerjes së punësimit, nuk mund:

- të kryejë përfaqësimin si përfaqësues i organizate ndërkombëtare ose tjetër e cila me organin në të cilin ka punuar paraprakisht kanë ose vendosin marrëdhënie kontraktuese, respektivisht afariste.

- të përfaqësojë person juridik ose fizik para organit në të cilin ka kryer autorizime publike në lëndë për të cilat personi zyrtar ka marrë pjesë në miratimin e vendimeve,

- të kryejë punë menaxhimi ose revizioni në personin juridik në të cilin të paktën një vit para përfundimit të kryerjes së autorizimeve publike, puna e tij ka qenë e lidhur me funksionin e supervizionit ose mbikëqyrjes.

Neni 48

Personi i zgjedhur ose i emëruar, si dhe personi tjetër zyrtar ose personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik ose personi tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror që në afat prej tre viteve nga dita e ndërprerjes së kryerjes së autorizimeve ose detyrave publike, do të themelojë shoqëri tregtare ose do të fillojë të merret me veprimtari me të cilën do të realizojë profit në sferën që ka punuar si person zyrtar, detyrohet që për këtë, në afat prej 30 ditësh, ta njoftojë Komisionin Shtetëror.

### Anëtarësimi në organe drejtuese dhe mbikëqyrëse

Neni 49

(1) Personi i zgjedhur ose i emëruar nuk mund të jetë anëtar i organit drejtues ose mbikëqyrës në shoqëri tregtare, ndërmarrje publike, agjenci, fonde dhe të gjithë personat tjerë juridikë me kapital shtetëror dominues, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) I punësuari në sektor publik, mund të jetë anëtar i një organi drejtues ose mbikëqyrës në shoqëri tregtare, ndërmarrje publike, agjenci, fonde dhe të gjithë personat tjerë juridikë me kapital shtetëror dominues.

### Ndalimi për keqpërdorim të të dhënave zyrtare

Neni 50

(1) Personi zyrtar nuk mund t'i shfrytëzojë informatat me të cilat disponon në kryerjen e funksioneve, autorizimet publike dhe detyrat zyrtare për realizimin e përparësive për vete ose për tjetrin.

(2) Detyrimi nga paragrafi (1) i këtij neni mbetet në afat prej tre viteve nga dita e pushimit të funksionit, respektivisht detyrës, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe.

(3) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon të mbajë të dhëna në fshehtësi që sipas këtij ligji ose ligjit tjetër doemos duhet të publikohen ose të kërkojë qasje në të dhënat për të cilat e di se nuk është i autorizuar t'i pranojë ose të sillet në mënyrë të papërgjegjshme me ruajtjen e të dhënave që paraqesin sekret në përputhje me ligjin.

### Kufizimet në bashkëpunim me persona juridikë

Neni 51

(1) Personi zyrtar në kryerjen e funksionit të tij, autorizimeve publike ose detyrave mund të vendosë marrëdhënie afariste me personin juridik i cili është në pronësi të tij apo në pronësi të anëtarit të familjes së tij, ose në të cilin ai ose anëtar i familjes së tij posedon aksione ose pjesëmarrje ose të cilin e ka themeluar ai ose anëtar i familjes së tij, ose në të cilin personi përgjegjës është anëtar i familjes së tij.

(2) Nëse personi zyrtar vepron në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni, për marrëveshjen e lidhur zbatohen dispozitat për shfuqizim të marrëveshjes nga Ligji për marrëdhënie obliguese.

### Ndalimi për shfrytëzimin e huave dhe llojeve tjera të përkrahjes nga shteti

Neni 52

Personi juridik themelues ose pronar i të cilit ka qenë ose është zgjedhur ose emëruar personi, ose themelues ose pronar i të cilit është ose ka qenë anëtar i familjes së tij, ose në të cilin personi i familjes së tij është person përgjegjës, ose në të cilin personi i zgjedhur ose emëruar përkatësisht anëtar i familjes së tij posedon pjesëmarrje ose aksione, nuk mund të jetë shfrytëzues i grantit, huas përkatësisht përkrahjes financiare nga shteti ose nga njëësia e vetëqeverisjes lokale.

**Disponimi me pronë shtetërore**

## Neni 53

Personi i zgjedhur ose i emëruar ose personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror detyrohet që menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej dhjetë ditëve të raportojë në Komisionin Shtetëror çdo qarkullim me pronësi shtetërore me të cilin hyn në fuqi ligjore me personin juridik të themeluar nga ai ose një anëtar i familjes së tij ose në të cilin personi përgjegjës është anëtar i familjes së tij.

**Shfrytëzimi ekonomik i mjeteve shtetërore**

## Neni 54

Çdo person zyrtar obligohet që t'i ruajë mjetet shtetërore të cilat i janë besuar dhe me ato të disponojë në mënyrë më ekonomike dhe për dedikimet e përcaktuara prej më parë. Ndalohet që mjetet të shfrytëzohen për qëllime private ose t'i jepen një tjetri për shfrytëzim.

**Ndalimi për fitim të të drejtave aksionare**

## Neni 55

(1) Personi zyrtar nuk mundet gjatë kohëzgjatjes së mandatit respektivisht detyrës, si dhe në afat prej tre vitesh pas ndërprerjes së tyre të fitojë të drejta aksionare në çfarë do lloj baze ose në çfarë do lloj forme në person juridik mbi të cilin ai ose organi në të cilin punon ose ka punuar, kryen përkatësisht ka kryer mbikëqyrje, përveç nëse këto të drejta janë fituar me trashëgimi.

(2) Fitimin e të drejtave aksionare gjatë kohëzgjatjes së mandatit respektivisht detyrës zyrtare ose punësimit, personi nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet ta paraqesë në Komisionin Shtetëror brenda 30 ditëve nga data e marrjes së tyre.

**Ndalimi i ndikimit për punësim të familjarëve të afërt**

## Neni 56

(1) Personi zyrtar nuk guxon të ndikojë në punësimin ose avancimin e personit të afërt në organin në të cilin ai është zgjedhur ose emëruar, ose në ndonjë organ tjetër shtetëror ose ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik që disponon kapital shtetëror mbi të cilin kryen mbikëqyrje organi në të cilin personi është zgjedhur, përkatësisht është emëruar.

(2) Personi i zgjedhur ose i emëruar ose personi përgjegjës në një ndërmarrje publike dhe person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror obligohet ta njoftojë Komisionin Shtetëror për çdo zgjedhje, emërim ose punësim, avancim të një anëtari të familjes së tij në një organ shtetëror, një organ të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrje publike ose person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, në afat prej dhjetë ditësh nga dita e zgjedhjes përfundimtare, emërimit, avancimit ose punësimit.

**Ndalimi për ndikimin ndaj procedurave për furnizime publike**

## Neni 57

(1) Personi zyrtar nuk guxon të kryejë ndikim joligjor në procedurën për furnizim publik.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet edhe kur në bazë të konkursit publik, shpalljes ose licitacionit vendoset për dhënie të miratimeve, koncesioneve, kontingjenteve ose lejeve për kryerje të veprimtarisë ekonomike ose veprimtarisë tjetër fitimprurëse.

**Ndalimi për pranim të dhuratave**

## Neni 58

(1) Personi zyrtar gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave publike nuk guxon të marrë dhurata, përveç rasteve, në shumën dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për shfrytëzim dhe disponim me gjësendet në pronësi shtetërore dhe me gjësendet në pronësi komunale përkatësisht Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

(2) Organet shtetërore dhe organet tjera dhe organizatat janë të detyruara të dorëzojnë te Komisioni Shtetëror kopje të listës së evidencës për dhuratat e pranuar nga paragrafi (1) i këtij neni, më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhës për vitin paraparak.

(3) Nëse Komisioni Shtetëror gjatë shqyrtimit të listës nga paragrafi (2) i këtij neni përcakton shmangie nga kriteret ligjore të përcaktuara, për atë e njofton organin ose institucionin i cili e ka dorëzuar listën.

(4) Nëse Komisioni Shtetëror vlerëson se personi zyrtar ka marrë dhuratë që ndikon ose mund të ndikojë ndaj ushtrimit objektiv dhe të paanshëm të funksioneve, autorizimeve publike ose detyrimeve zyrtare për këtë i njofton organet kompetente, kurse dhuratat bëhen pronësi e Republikës së Maqedonisë ose e njësisë së bashkësisë lokale.

**Sponsorimet ose donacionet**

## Neni 59

(1) Personi i zgjedhur ose i emëruar ose personi përgjegjës në ndërmarrje publike dhe person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, në lidhje me ushtrimin e funksioneve publike, autorizimeve dhe detyrave, nuk mund të lidhë marrëveshje për sponsorim në emër të tij.

(2) Personi juridik ose fizik mbi të cilin personi i zgjedhur ose i emëruar ose personi përgjegjës në ndërmarrje publike dhe person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror kryen ose ka kryer mbikëqyrje nuk mund të jetë dhënësi i sponsorimit ose donacionit të personi juridik në të cilin personi zyrtar ose anëtar i familjes së tij ka interes.

(3) Personi juridik ose personi fizik mbi të cilin personi i zgjedhur ose i emëruar ose personi përgjegjës në ndërmarrje publike dhe person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror nuk guxon të lidhë marrëveshje për sponsorim dhe as të pranojë donacion në emër të organit në të cilin kryhen autorizime publike, të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në ligjshmërinë, realizim objektiv dhe të paanshëm të autorizimeve publike.

**Kapitulli i gjashtë****PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË KRYERJEN E PUNËVE ME INTERES PUBLIK DHE VEPRIMTARI TJERA TË PERSONAVE JURIDIKË****Kërkesa të paligjshme të eprorit**

## Neni 60

(1) Personi zyrtar prej të cilit eprori i tij ose personi i zgjedhuri ose i emëruar kërkon në kryerjen e shërbimit të veprorë në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose rregullë tjetër, detyrohet për këtë ta sugjerojë atë që ka dhënë urdhëresën.

(2) Nëse edhe pas sugjerimit me gojë, eprori i drejtpërdrejt e përsërit urdhrin nga paragrafi (1) i këtij neni personi zyrtar për këtë menjëherë me shkrim do ta njoftojë eprorin më të lartë të drejtpërdrejtë nga ai që e ka dhënë urdhrin dhe Komisionin Shtetëror. Pas sugjerimit me shkrim, personi zyrtar është liruar nga detyrimi për kryerjen e paligjshme të veprimit zyrtar dhe nuk mundet për atë të thirret në përgjegjësi, e as të bartë pasoja.

(3) Personi zyrtar i cili ka vepruar në pajtim me detyrimin për sugjerim të përcaktuar me këtë nen ka të drejtë të mbrojtjes në pajtim me nenin 42 të këtij ligji, si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtje të denoncuesve.

(4) Pas njoftimit nga paragrafi (2) i këtij neni, Komisioni shtetëror ndërmerr masa si pas kallëzimit nga denoncuesi, në procedurë dhe afate të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për mbrojtje të denoncuesve.

**Mosparaqitja e veprës ndëshkuese**

## Neni 61

Personi zyrtar detyrohet ta paraqesë çdo veprës ndëshkuese lidhur me korrupsionin, si dhe çdo shkelje të dispozitave të këtij ligji, për të cilat është njoftuar në kryerjen e detyrës së vet.

**Ndalimi i kryerjes së ndikimit mbi tjetrin**

## Neni 62

(1) Personi zyrtar nuk guxon ta shfrytëzojë gjendjen e tij duke kryer ndikim mbi personin tjetër në organ shtetëror, ndërmarrje publike, institucion publik ose person tjetër juridik, për atë të miratojë ose të mos miratojë vendim të caktuar, të bëjë diçka, të lëshojë ose të durojë, për shkak të realizimit të dobisë.

(2) Çdo qytetar ka të drejtë ta njoftojë Komisionin Shtetëror për shkelje të dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni.

**Kryerja e autorizimeve diskrete**

## Neni 63

(1) Në kryerjen e autorizimeve diskrete çdo person zyrtar detyrohet që vendimet t'i miratojë me ndërgjegje, duke mbajtur llogari për të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit konkret dhe për parimin e ligjshmërisë dhe drejtësisë.

(2) Personi fizik ose juridik që nuk është i kënaqur nga vendimi i miratuar në bazë të autorizimit diskret dhe i cili konsideron se ai vendim është miratuar për shkak të korruptimit, mund të paraqesë parashtrësë para Komisionit Shtetëror.

(3) Komisioni Shtetëror detyrohet ta shqyrtojë parashtrësën nga paragrafi (1) i këtij neni dhe në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të parashtrësës ta njoftojë personin fizik përkatësisht personin juridik për veprimin për të njëjtën.

(4) Komisioni Shtetëror dy herë në vit në ueb faqen e vet shpall të dhënë statistikore për parashtrësat e parashtruara nga paragrafi (1) të këtij neni.

**Oferta e ryshfetit**

## Neni 64

Personi zyrtar të cilit i është ofruar ryshfet, detyrohet të marrë masa për identifikimin e ofruesit dhe ta paraqesë në organin kompetent.

**Procedura në rast të akuzës për korrupsion**

## Neni 65

Personi zyrtar i cili është i dënuar për veprë korruptuese pa prolongim e njofton organin i cili e ka zgjedhur ose emëruar, përkatësisht eprorin e tij.

**Pavlefshmëria e akteve juridike**

## Neni 66

(1) Aktet juridike që janë rezultat i korrupsionit ose janë miratuar përkatësisht të lidhura për shkak të korrupsionit janë të pavlefshme.

(2) Çdokush i cili ka interes juridik mund të kërkojë anulim të akteve juridike nga paragrafi (1) i këtij neni, me parashtrim si dëshmi vendim gjyqësor të plotfuqishëm përkatësisht vendim të organit kompetent me të cilin është përcaktuar ekzistim i korrupsionit ose konflikt i interesave.

**Keqpërdorimi i kryerjes së punëve me interes publik**

## Neni 67

(1) Personi i cili kryen punë me interes publik nuk guxon ta keqpërdorë pozitën e vet për realizimin e interesit.

(2) Si punë me interes publik, përveç veprimtarive të përcaktuara me ligj si punë me interes publik, konsiderohen edhe aktivitetet që kryhen në kuadër të veprimit të partive politike, sindikatave, shoqatave dhe fondacioneve.

**Mbrojtja e mjeteve për informim publik**

## Neni 68

(1) Ndalohet çdo lloj detyrimi, parandalimi ose ndikimi tjetër në mënyrë tjetër mbi mjetet për informim publik që të publikojnë ose të mos publikojnë informacione për rastet e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

(2) Gazetari ka të drejtë të qasjes papengesë në të gjitha burimet e informatave në pajtim me ligjin. Askush nuk mund ta përjashtojë publikun nga debati për korrupsion dhe konflikti i interesave para organit kompetent ose personit juridik, përveç nëse bëhet fjalë për procedurë paraprake e cila është shpallur si e besueshme.

(3) Askush nuk mund të kërkojë nga gazetari i cili ka publikuar informatë për një akt korrupsioni dhe për konflikt të interesave që ta zbulojë burimin e informatës.

**Keqpërdorimi i mjeteve për informim publik**

Neni 69

(1) Kushdo që publikon informacione mbi korrupsionin e tjetrit duhet të respektojë pafajësinë e supozuar dhe parimet e informacionit të vërtetë, objektiv dhe të paanshëm, si dhe parimet tjera të kodit të etikës profesionale.

(2) Askush nuk mund të shfrytëzojë mjet për informim publik për akuzim të rrejshëm të një personi tjetër për korrupsion.

**Keqpërdorimet në punën financiare**

Neni 70

(1) Çdo i punësuar në bankë, kursimore, këmbimore, shoqëri sigurimi, bursë ose organizatë tjetër financiare obligohet që menjëherë të paraqesë një transaksion të dyshimtë lidhur me korrupsionin. Fletëparaqitja i dorëzohet personit përgjegjës në atë person juridik dhe organeve të përcaktuara me ligj, si dhe Komisionit Shtetëror.

(2) Organizatori i bursës obligohet të mbajë evidencë dhe regjistër të të gjitha transaksioneve të kryera në bursë.

**Parandalimi i korrupsionit në shoqëritë tregtare**

Neni 71

(1) Personi përgjegjës në shoqërinë tregtare ose personi tjetër juridik nuk guxon të përdorë pozitën e tij, të marrë shpërblim ose ndonjë përfitim ose premtim tjetër për të, për vete ose për një tjetër, për shkak të:

- krijimit të pozitës monopole të tregut,
- diskriminimit të shoqërive tjera tregtare ose personave tjerë juridikë,
- shkakimit të çrregullimit të tregut dhe
- shkakimit të dëmit të personit tjetër juridik ose një personi tjetër që nuk është rezultat i konkurrencës lojale të tregut.

(2) Marrëveshjet dhe aktet tjera juridike që janë rezultat i korrupsionit të personit përgjegjës, si dhe marrëveshjeve që rrjedhin nga korrupsioni, d.m.th. realizimin e përfitimeve të paligjshme për personin juridik, janë të pavlefshme.

(3) Shfaqja e pasojës nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni përbën bazën për paraqitjen e padisë nga personi i dëmtuar për kompensimin e dëmit (dëmin real dhe fitimi i humbur).

(4) Nëse ekziston dyshimi bazë për vërtetësinë e llogarisë përfundimtare vjetore të dorëzuar nga personi juridik ose në librat tjera afariste dhe dokumentet financiare, me kërkesë të Komisionit Shtetëror, Drejtoria për të Hyra Publike do të kryejë kontrollin e punës materiale dhe financiare.

(5) Nëse ekziston dyshimi bazë për vërtetësinë e të dhënave mbi punën financiare dhe materiale të shoqërisë tregtare ose personit tjetër juridik, me kërkesë të Komisionit Shtetëror, organet kompetente do të kontrollojnë punën materiale dhe financiare të atij personi juridik.

(6) Nëse, pas kontrollit të kryer nga paragrafi (5) i këtij neni konstatohen parregullsi, Drejtoria për të Hyra Publike kundër personit përgjegjës në shoqërinë tregtare dhe

personit tjetër juridik, respektivisht anëtarëve të organit të menaxhimit në person juridik, do të ngre procedurë për shqyrtimin e gjendjes pronësore.

**Kapitulli i shtatë****PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE****Veprimi në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave**

Neni 72

(1) Personi zyrtar në punën e vet obligohet të kujdeset për konfliktin potencial të interesave dhe të ndërmarrë masa për mënjanimin e tyre.

(2) Në rast dyshimi për ekzistimin e konfliktit të interesave, personi zyrtar detyrohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndikimin e interesit të tij privat ose të interesit privat të një personi tjetër gjatë ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave, dhe për këtë ta njoftojë eprorin e tij.

(3) Në raste të ekzistimit të dyshimit për konflikt të interesave, personi zyrtar obligohet të kërkojë mendim nga Komisioni Shtetëror.

**Paraqitja e gjendjes së konfliktit të interesave**

Neni 73

(1) Nëse personi zyrtar merr pjesë në debatin e organit ose trupit ku vendoset për punët për të cilat ai ose personi i afërt ka interes publik, personi zyrtar obligohet ta paraqesë ekzistimin e interesit publik dhe të përjashtohet nga debati dhe vendimmarrja, ndërsa më së voni para fillimit të vendimmarrjes.

(2) Organi ose trupi në mbledhjen e të cilit personi nga paragrafi (1) i këtij neni e ka kumtuar ekzistimin e interesit privat obligohet që ta konstatojë dhe ta vendosë atë në procesverbal.

(3) Ndërprerja e ekzistimit të interesit privat nga personi zyrtar parqet shkelje të detyrës dhe bazë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë dhe shqiptimin e masave në pajtim me këtë ligj.

Neni 74

(1) Personi zyrtar i cili merr pjesë ose vendos në procedurën për zgjedhje, emërim ose punësim ose është përfshirë si anëtar i trupit që e zbaton atë procedurë ka për detyrë ta njoftojë personin udhëheqës në organin përkatësisht institucionin ku personi zyrtar kryen autorizime publike për të gjitha procedurat që mund të shkaktojnë konflikt interesash.

(2) Pas përcaktimit të marrëdhënies së personit zyrtar me kandidatin për zgjedhje, emërim ose punësim, personi udhëheqës nga paragrafi (1) i këtij neni ka për detyrë t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për parandalimin e paraqitjes së konfliktit të interesave.

(3) Në rast të dyshimit për ekzistimin e konfliktit të interesave në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi zyrtar dhe personi udhëheqës nga paragrafi (1) i këtij neni mund të kërkojnë mendim nga Komisioni Shtetëror.

**PËRJASHTIMI**

Neni 75

(1) Kur personi zyrtar do të dijë për rrethanat që sugjerojnë në ekzistimin e konfliktit të interesave ose të konfliktit potencial të interesave, ka për detyrë menjëherë të kërkojë të përjashtohet dhe të ndërpresë veprimin e vet.



(2) Personi zyrtar do të përjashtohet nga kryerja e veprimtarisë së caktuar me vendim të organit në të cilin është zgjedhur ose emëruar, përkatësisht ku kryen funksione, autorizime publike ose detyra zyrtare dhe me kërkesë të personit të interesuar i cili ka kuptuar për rrethanat që sugjerojnë në ekzistimin e konfliktit të interesave ose të konfliktit potencial të interesave.

### **Procedura para Komisionit Shtetëror për përcaktimin e konfliktit të interesave**

#### **Neni 76**

(1) Në rast kur ekziston dyshimi për ekzistimin e konfliktit të interesave, Komisioni Shtetëror ngrit procedurë për përcaktimin e ekzistimit të konfliktit të interesave.

(2) Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni ngrihet:

- me detyrë zyrtare,
- me kërkesë të personit zyrtar,
- me paraqitje të personit tjetër,
- me kërkesë të personit udhëheqës në organin përkatësisht institucionin ku personi zyrtar kryen funksione, autorizime publike ose detyra zyrtare dhe
- me paraqitje anonime.

(3) Në procedurën nga paragrafi (1) i këtij neni, për shkak të përcaktimit të gjendjes faktike në rastin, Komisioni Shtetëror mbledh dokumente, të dhëna dhe informata nga personat fizikë dhe juridikë, si dhe nga personi zyrtar.

(4) Subjektet nga paragrafi (3) i këtij neni kanë për detyrë t'i dorëzojnë dokumentet, të dhënat dhe informatat me të cilat disponojnë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga Komisioni Shtetëror.

(5) Nëse subjektet nga paragrafi (3) i këtij neni nuk prononcohen në afatin e përcaktuar me paragrafin (4) të këtij neni, Komisioni Shtetëror i kontrollon konstatimet për ekzistimin e konfliktit të interesave me detyrë zyrtare.

(6) Komisioni Shtetëror ka për detyrë të miratojë vendim për ekzistimin ose mosegzistimin e konfliktit të interesave në afat prej 30 ditësh pas prononcimit të subjekteve nga paragrafi (3) i këtij neni, përkatësisht pas kontrollit të konstatimeve.

#### **Neni 77**

(1) Nëse Komisioni Shtetëror konstaton ekzistimin e konfliktit të interesave, ka për detyrë ta njoftojë personin zyrtar dhe të kërkojë prej tij në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i vendimit ta mënjanojë konfliktin e interesave.

(2) Nëse personi zyrtar vepron sipas kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni Shtetëror e ndërpret procedurën dhe për këtë i njofton personin zyrtar dhe parashtruesin e fletëparaqitjes.

(3) Nëse personi zyrtar nuk vepron sipas kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për këtë nuk e njofton Komisionin Shtetëror në afatin e përcaktuar, Komisioni Shtetëror pa prolongim për këtë e njofton organin kompetent:

- me kërkesë që të ngrihet procedurë disiplinore, nëse personi zyrtar nuk është person i zgjedhur ose emëruar ose
- me iniciativë për shkarkim / ndërprerje të kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave, nëse personi zyrtar është person i zgjedhur ose emëruar ose

- me ç'rast shqipton masë vërejtje publike në pajtim me nenin 79 të këtij ligji, nëse personi zyrtar është person i zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta.

#### **Neni 78**

Organi tek i cili është dorëzuar iniciativa për ngritjen e procedurës disiplinore përkatësisht procedurës për shkarkim, ka për detyrë për të të miratojë vendim më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit të iniciativës.

#### **Neni 79**

(1) Nëse personi zyrtar që është zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta nuk vepron në pajtim me kërkesën nga neni 77 paragrafi (1) të këtij ligji, Komisioni Shtetëror miraton vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike, të cilën ia dorëzon personit zyrtar.

(2) Vërejtja publike nga paragrafi (1) i këtij neni publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror.

### **Obligimi për njoftimin e opinionit për rastet e konfliktit të interesave**

#### **Neni 80**

(1) Komisioni Shtetëror e njofton publikun për rastet e konfliktit të interesave për të cilat ai ka vepruar, në pajtim me këtë ligj.

(2) Komisioni Shtetëror ka për detyrë të dhënat të cilat ka ardhur gjatë mbajtjes së procedurës për përcaktimin e ekzistimit të konfliktit të interesave t'i mbrojë nga keqpërdorimet për diskriminim ose nënvlerësim të personit zyrtar.

#### **Neni 81**

Të dhënat për personin zyrtar të cilat Komisioni Shtetëror ka ardhur në kryerjen e punëve nga kompetenca e vet mund t'u jepen në këqyrje gjykatave, organeve inspektuese dhe organeve tjera shtetërore kompetente, me atë që të dhënat nuk guxon të keqpërdoren për diskriminim ose nënvlerësim të personit zyrtar ose publikisht të publikohen sikur të jenë të dhëna që i ka përcaktuar gjykata ose organi tjetër kompetent.

### **Kapitulli i tetë**

#### **PARAQITJA E GJENDJES PRONËSORE DHE INTERESAVE**

#### **Neni 82**

(1) Personi i zgjedhur ose i emëruar, personi përgjegjës në ndërmarrjen publike, institucioni publik ose personi tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, noteri, përmbaruesi, nëpunësi administrativ i kategorisë A të përcaktuar me ligj ose personi i punësuar në kabinetet e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryetarët e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrat dhe sekretari i përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shkak të kryerjes së detyrave të punës të këshilltarit të veçantë, gjatë zgjedhjes, emërimit, përkatësisht punësimit, e më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e zgjedhjes, emërimit, caktimit, përkatësisht punësimit parashtron deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat.

(2) Deklarata nga paragrafi (1) i këtij neni përmban:  
- regjistrim të hollësishtëm të pronës së patundshme, sendeve të tundshme me vlerë që tejkalon shumë prej njëzet rroga mesatare neto në periudhën tremujore paraprake, letrave me vlerë dhe kërkesave dhe borxheve, si dhe pronës tjetër që është në pronësi të tij, ose pronësi të anëtarëve të familjes së tij, me theksimin e bazës për marrje të pronës së paraqitur,

- deklaratë për interesat për të dhe për anëtarët e familjes së tij, që përmban informatë për vendet e punës dhe anëtarësinë në këshillat administrativë, anëtarësinë në shoqata dhe fondacione dhe të dhëna të tjera që nevojiten në pajtim me formularin e përcaktuar.

(3) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni obligohet të parashtrorë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat dhe në afat prej 30 ditësh nga dita e ndërprerjes së funksionit përkatësisht punësimi.

(4) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni deklaraten për gjendjen pronësore dhe interesat e dorëzon te Komisioni Shtetëror.

(5) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni deklaraten për gjendjen pronësore dhe interesat e parashtron në formë elektronike, me ç'rast dorëzon edhe kopje të shtypur te Komisioni Shtetëror.

#### Neni 83

Në bazë të vlerësimit të rrezikut nga korrupsioni, me ligj i cili rregullon kryerje të veprimtarisë nga sfera e mbrojtjes, punëve të brendshme ose financave, mund të përcaktohet obligim për parashtrimin e deklarates për gjendje pronësore dhe interesa nga personat me autorizime të veçanta.

#### Neni 84

Komisioni Shtetëror mund të kërkojë nga personi zyrtar i cili në pajtim me këtë ligj nuk ka obligim të parashtrorë deklarate për gjendjen pronësore dhe interesat, të dorëzojë deklarate, si dhe të zbatojë procedurë për kontrollin e gjendjes së tij pronësore, kur vepron sipas lëndës në të cilën është përfshirë ky person.

### **Paraqitja e ndryshimeve në gjendjen pronësore dhe interesat**

#### Neni 85

(1) Personi i zgjedhur ose i emëruar dhe personi përgjegjës në ndërmarrjen publike ose personi tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, noteri, përmbartuesi ose nëpunësi administrativ i kategorisë A të përcaktuar me ligj ose personi i punësuar në kabinetet e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryetarët e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrat dhe sekretari i përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shkak të kryerjes së detyrave të punës të këshilltarit të veçantë, ka për detyrë në afat prej 30 ditësh ta paraqesë çdo rritje të pronës së tij, përkatësisht pronës së anëtarit të familjes së tij, në vlerë që tejkalon shumë e njëzet rrogave mesatare neto në periudhën tremujore paraprake, si dhe ndryshimin e interesave (në tekstin e mëtejme: paraqitja e ndryshimeve në gjendjen pronësore dhe interesat).

(2) Obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni ka të bëjë edhe me personat nga neni 83 i këtij ligji.

(3) Në fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni bashkëngjitet edhe marrëveshja ose dokumenti tjetër që është bazë për ndryshim.

(4) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni paraqitjen e ndryshimeve në gjendjen pronësore dhe interesat e kryejnë me parashtrimin elektronik të formularit për ndryshimin e gjendjes pronësore dhe interesave, te Komisioni Shtetëror. Kopja e shtypur nga parashtrimi elektronik i formularit parashtrorë te Komisioni Shtetëror.

(5) Personat nga paragrafi (2) i këtij neni paraqitjen e ndryshimeve në gjendjen pronësore dhe interesat e kryejnë me parashtrimin me shkrim të formularit për ndryshimin e gjendjes pronësore dhe interesave, te organet në të cilat janë të punësuar.

#### Neni 86

Formën dhe përmbajtjen e formularit të deklarates për gjendjen pronësore dhe interesat dhe të formularit për paraqitjen e ndryshimeve në gjendjen pronësore dhe interesat i përcakton Komisioni Shtetëror.

### **Transparenca në deklaraten për gjendjen pronësore dhe interesat**

#### Neni 87

(1) Të dhënat e deklarates për gjendjen pronësore dhe interesat dhe fletëparaqitjen për ndryshimin në gjendjen pronësore dhe interesat paraqesin informata me karakter publik, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj.

(2) Të dhënat e deklarates për gjendjen pronësore dhe interesat dhe fletëparaqitjen për ndryshimin në gjendjen pronësore dhe interesat, të parashtruara te Komisioni Shtetëror, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj, publikohen në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror.

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

#### Neni 88

(1) Të dhënat personale që grumbullohen në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, përpunohen dhe ruhen në mënyrë të drejtë dhe përkatëse për qëllime konkrete dhe të qarta të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

(2) Të dhënat personale nga paragrafi (1) i këtij neni ruhen në formën që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave personale.

(3) Të dhënat personale nga paragrafi (1) i këtij neni ruhen jo më gjatë se sa që nevojitet të përmbushen qëllimet për shkak të të cilave të dhënat janë grumbulluar për përpunim të mëtejme në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(4) Me kërkesë të subjektit të të dhënave personale, Komisioni Shtetëror ka për detyrë t'i plotësojë, ndryshojë, shlyejë ose ta ndërpresë shfrytëzimin e të dhënave personale, nëse të dhënat janë të paplota, të pasakta ose të paazhurnuara dhe nëse përpunimi i tyre nuk është në pajtim me ligjin.

(5) Në përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni subjekti i të dhënave personale thekson për cilat të dhëna kërkohet plotësimi, ndryshimi, shlyerja ose ndërprerja e shfrytëzimit të të dhënave personale dhe nëse kërkohet plotësimi ose ndryshimi, theksohen edhe të dhënat me të cilat duhet të bëhet plotësimi ose ndryshimi.

(6) Në rast kur do të përcaktohet se të dhënat personale janë të paplota, të pasakta ose të paazhurnuara, Komisioni Shtetëror ndërmerri masa që këto të plotësohen, ndryshohen ose të shlyhen, pavarësisht asaj nëse subjekti i të dhënave personale ka parashtruar kërkesë për plotësimin ose ndryshimin e të dhënave personale.

(7) Për plotësimin, ndryshimin ose shlyerjen e kryer të të dhënave personale, në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, Komisioni Shtetëror më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim e njofton subjektin e të dhënave personale, shfrytëzuesit e të dhënave personale ose personat e tretë të cilëve u janë zbuluar të dhënat personale në pajtim me ligjin.

### Regjistri

#### Neni 89

(1) Komisioni Shtetëror mban regjistër të personave të zgjedhur dhe të emëruar, personave përgjegjës në ndërmarrjet publike, institucionet publike ose personave tjerë juridikë të cilët disponojnë me kapital shtetëror, noterëve, përmbartuesve dhe nëpunësve administrativë të kategorisë A të përcaktuar me ligj ose personi i punësuar në kabinetet e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryetarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrave dhe sekretarit të përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shkak të kryerjes së detyrave të punës të këshilltarit të veçantë, të cilët kanë për detyrë të parashtrorinë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat (në tekstin e mëtejme: Regjistri).

(2) Regjistri paraqet bazë unike.

#### Neni 90

(1) Të dhënat që futen në Regjistër paraqesin informata me karakter publik, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj.

(2) Të dhënat nga Regjistri të cilat nuk janë të mbrojtura me ligj publikohen në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror.

#### Neni 91

(1) Personat udhëheqës në institucionet dhe organet që kryejnë zgjedhjet dhe emërimet ose personat e autorizuar prej tyre kanë për detyrë që të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji me plotësimin e formularit t'i dorëzojnë te Komisioni Shtetëror pa prolongim, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhjes dhe emërimit, si dhe pas ndërprerjes së funksionit, përkatësisht detyrës së personit të zgjedhur ose të emëruar.

(2) Komisioni Shtetëror ka për detyrë që të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji t'i vendosë në Regjistër në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tyre.

(3) Të dhënat e evidentuara për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji dhe dokumentacioni i bashkëngjitur në to ruhen në pajtim me ligjin.

(4) Të dhënat nga paragrafi (3) i këtij neni të vendosura në Regjistër në formë elektronike e që janë publikuar, tërhiqen nga ueb faja e Komisionit Shtetëror pas kalimit të afatit prej dhjetë vitesh pas ndërprerjes së ushtrimit të funksionit të personit të cilit i referohen të dhënat.

(5) Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit i përcakton Komisioni Shtetëror.

### Procedura për kontrollin e të dhënave për gjendjen pronësore dhe interesat

#### Neni 92

(1) Komisioni Shtetëror kryen kontroll të vërtetësisë së të dhënave të vendosura në deklaratën për gjendjen pronësore dhe interesat në rast kur vepron në lëndën konkrete ose në bazë të planit vjetor nga neni 19 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Komisioni Shtetëror e kryen kontrollin nga paragrafi (1) i këtij neni, me grumbullimin, krahasimin dhe analizën e të dhënave të marra nga personat juridikë dhe fizikë të cilët disponojnë me të dhënat e nevojshme.

### Kontrolli i gjendjes pronësore

#### Neni 93

(1) Nëse ekziston dyshim i bazuar se prona e personit i cili në pajtim me këtë ligj ka për detyrë të parashtrorinë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat është rritur në mënyrë të papërpjesëtueshme në krahasim me të ardhurat e tij të rregullta ose të ardhurat e anëtarëve të familjes së tij, Komisioni Shtetëror ngrit procedurë për kontrollin e gjendjes pronësore.

(2) Gjatë kontrollit të gjendjes pronësore nga paragrafi (1) i këtij neni Komisioni Shtetëror e fton personin për të cilin mbahet procedura të dorëzojë të dhëna për bazën për fitimin e pronës. Personi ka për detyrë me kërkesë të Komisionit Shtetëror të përgjigjet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

#### Neni 94

(1) Organet shtetërore, organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, bartësit e qarkullimit pagesor dhe personat tjerë fizikë dhe juridikë, me kërkesë të Komisionit Shtetëror dhe në afatin që ai do ta caktojë, kanë për detyrë t'i japin të gjitha informatat e nevojshme për përcaktimin e gjendjes faktike që janë të rëndësishme për kontrollin e të dhënave dhe kontrollin e pronës dhe gjendjes pronësore.

(2) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk veprojnë sipas kërkesës së Komisionit Shtetëror në afatin e përcaktuar me nenin 23 paragrafin (3) të këtij ligji, ata kanë për detyrë për shkaqet për mosveprimin ta njoftojnë pa prolongim Komisionin Shtetëror.

(3) Për rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, Komisioni Shtetëror e njofton organin i cili kryen mbikëqyrje mbi punën e subjekteve nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërsa mund të parashtrorinë edhe raport të veçantë te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, ose ta njoftojë publikun.

#### Neni 95

(1) Nëse në procedurën për kontrollin e pronës dhe gjendjes pronësore nuk dëshmohet se prona është fituar ose rritur si rezultat i të ardhurave që janë paraqitur dhe titimuar, Komisioni Shtetëror kundër personit për të cilin e ka mbajtur këtë procedurë parashtron iniciativë për ngritjen e procedurës penale te prokuroria publike kompetente.

(2) Për veprimet e ndërmarra nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni Shtetëror e njofton organin të cilin e ka emëruar, e ka zgjedhur ose në të cilin personi është i punësuar, përkatësisht ku e ushtron funksionin.

## Neni 96

Nëse ekzistojnë dëshmi se anëtari i familjes ose personi i afërt i personit zyrtar, ka fituar pronë të konsiderueshme gjatë kohës së kryerjes së autorizimeve publike përkatësisht detyrave të personit zyrtar, i cili i tejkalon të ardhurat e tij të rregullta, ndërsa ekziston dyshimi bazë se personi zyrtar me qëllim që ta fshehë prejardhjen e pronës ia ka bartur pronën atij anëtari të familjes përkatësisht personit të afërt, Komisioni Shtetëror do të iniciojë ngritjen e procedurës për kontrollimin e bazës së fitimit të pronës së atij anëtari përkatësisht personi të afërt.

**Procedurat për paraqitjen e shkeljeve të ligjit**

## Neni 97

(1) Komisioni Shtetëror ka për detyrë të vendos procedurë efikase për paraqitjen e shkeljes së këtij ligji i cili do të sigurojë:

- metodë të rëndomtë dhe lehtë të arritshme të parashtrimit të njoftimeve për shkeljen e kryer,
- procedura të brendshme për pranimin dhe hartimin e njoftimeve për shkeljen e kryer dhe
- mbrojtje të të dhënave personale të personit që ka dorëzuar njoftim për shkeljen e kryer në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(2) Komisioni Shtetëror nuk guxon ta zbulojë identitetin e personit që ka dorëzuar njoftim për shkeljen e bërë pa e siguruar pëlqimin e tij paraprak.

(3) Komisioni Shtetëror vepron edhe për parashtrësata anonime.

**Informatat për gjobot e shqiptuara**

## Neni 98

(1) Për qëllimet e parandalimit dhe kthimit nga realizimi i aktiviteteve të cilat konsiderohen kundërvajtje në pajtim me këtë ligj, Komisioni Shtetëror ka për detyrë publikisht t'i publikojë informatat për kontrollet e kryera, për procedurat e zbatuara dhe gjobot e shqiptuara për kundërvajtjet e kryera në pajtim me këtë ligj.

(2) Informatat nga paragrafi (1) i këtij neni përmbajnë të dhëna për:

- kryerësin e kundërvajtjes,
- kundërvajtjen: përshkrimin e veprimit që paraqet kundërvajtje dhe
- gjobën e shqiptuar.

(3) Informatat nga paragrafi (1) i këtij neni menjëherë pas kryerjes së procedurës publikohen në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror dhe këto duhet të jenë të arritshme në afat prej dy vitesh nga dita e publikimit.

## Neni 99

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e kryen Komisioni Shtetëror.

**Kapitulli i nëntë****DISPOZITAT E KUNDËRVAJTJES**

## Neni 100

Gjobë në shumë prej 200 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në institucionin kompetent ose personit të autorizuar prej tij, i cili nuk do t'i ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet

për dorëzimin e informatave të kërkuara nga Komisioni Shtetëror dhe këto nuk do t'i dorëzojë te Komisioni më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës (neni 23).

## Neni 101

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit financiar i cili në afat prej 15 ditësh te Komisioni Shtetëror nuk do t'i dorëzojë të dhënat e kërkuara në pajtim me nenin 25 të këtij ligji ose në pajtim me nenin 94 të këtij ligji.

(2) Personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij në institucionin financiar nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë.

## Neni 102

Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit i cili prej Komisionit Shtetëror është i ngarkuar për ekspertizë nëse i zbulon, publikon ose i ndan me personat e tretë të dhënat ose informatat që i ka marrë ose me të cilat është njoftuar në kornizat ose në lidhje me kryerjen e punës së vet (neni 28 paragrafi 1).

## Neni 103

Gjobë në shumë prej 200 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të organit kompetent ose personit të autorizuar prej tij, i cili:

- pas njoftimit të Komisionit Shtetëror për shkeljen e përcaktuar nga neni 24 paragrafi (1) të këtij ligji, me shkrim nuk e njofton Komisionin Shtetëror për masat e ndërmarra në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, përveç nëse ndryshe rregullohet me këtë ligj.

- në afat prej 60 ditësh nuk do ta njoftojë Komisionin Shtetëror për vendimet e miratuara në lidhje me iniciativat e ngritura nga neni 17, alinetë 4, 5 dhe 8 të këtij ligji dhe nuk do të japë informatë gjatë kohës së veprimit për iniciativat që i ka ngritur.

## Neni 104

Gjobë në shumën e caktuar në Kodin zgjedhor dhe në Ligjin për financim të partive politike do t'i shqiptohet partisë politike, përkatësisht organizatorit të fushatës zgjedhore të cilët në afatin e përcaktuar me ligj nuk do t'i dorëzojnë raportet që i dorëzojnë te Komisioni Shtetëror në pajtim me Ligjin për financim të partive politike dhe Kodin zgjedhor dhe në pajtim me nenin 31 dhe nenin 32 të këtij ligji.

## Neni 105

(1) Gjobë në shumë prej 300 deri më 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit zyrtar në ndërmarrje publike ose personit tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, nëse:

- në kundërshtim me nenin 44 ushtron ndonjë funksion tjetër, detyrë ose veprimtari që është i papërfundshëm me funksionin e tij,

- para kryerjes së autorizimeve publike si pronar ka menaxhuar me shoqëri tregtare ose institucion, gjatë kohës së kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave, nuk ia ka besuar menaxhimin personit tjetër në pajtim me nenin 45 të këtij ligji,

- punësohet në shoqërinë tregtare në të cilën ka kryer mbikëqyrje ose ka vendosur çfarëdo qoftë marrëdhënie kontraktuese gjatë kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave,

- ka fituar në çfarëdo baze me aksione përkatësisht pjesëmarrje në personin juridik në të cilin ka punuar, përkatësisht ka kryer mbikëqyrje,

- në afat prej dy vitesh pas ndërprerjes së kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave, përkatësisht pas ndërprerjes së punësimit bën përfaqësimin si përfaqësues i organizatës ndërkombëtare ose organizatës tjetër e cila me organin në të cilin paraprakisht ka punuar, kanë ose vendosin marrëdhënie kontraktuese, përkatësisht marrëdhënie afariste,

- në afat prej dy vitesh pas ndërprerjes së kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave, përkatësisht pas ndërprerjes së punësimit përfaqëson person juridik ose fizik para organit në të cilin ka kryer autorizime publike në lëndët për të cilat si person zyrtar ka marrë pjesë në miratimin e vendimeve,

- në afat prej dy vitesh pas ndërprerjes së kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave, përkatësisht pas ndërprerjes së punësimit kryen punë të menaxhimit ose revizionit në personin juridik në të cilin së paku një vjet para ndërprerjes së kryerjes së autorizimeve publike, puna e tij ka qenë e lidhur me funksionin e supervizorit ose funksionin mbikëqyrës,

- në afat prej tri vitesh nga dita e ndërprerjes së kryerjes së autorizimeve publike ose detyrave do të themelojë shoqëri tregtare ose do të fillojë të merret me veprimtarinë me të cilën realizohet profiti në sferën në të cilën ka punuar si person zyrtar, ndërsa për këtë nuk e ka njoftuar Komisionin Shtetëror në afat prej 30 ditësh,

- shfrytëzon informata me të cilat disponon për realizimin e dobisë për vete ose për tjetrin në afat prej tri vitesh nga dita e ndërprerjes së funksionit, përkatësisht detyrës, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe, si dhe nëse mban në sekret të dhëna që sipas këtij ose ligjit tjetër duhet të publikohen ose të kërkojë qasje në të dhënat për të cilat e di se nuk është i autorizuar t'i marrë, ose të silltet në mënyrë të papërgjegjshme ndaj ruajtjes së të dhënave që paraqesin sekret,

- vendos marrëdhënie afariste me personin juridik i cili është në pronësi të tij ose në pronësi të anëtarit të familjes së tij, ose në të cilin anëtari i familjes së tij është person përgjegjës, ose në të cilin personi i zgjedhur ose i emëruar përkatësisht personi përgjegjës posedon pjesëmarrje ose aksione ose të cilin e ka themeluar ai ose anëtari i familjes së tij ose në të cilin personi përgjegjës është anëtar i familjes së tij,

- person juridik themelues i të cilit ose pronar ka qenë ose është personi i zgjedhur ose i emëruar ose pronar është ose ka qenë anëtari i familjes së tij, ose në të cilin anëtar i familjes së tij është person përgjegjës, ose në të cilin personi i zgjedhur ose i emëruar përkatësisht personi përgjegjës posedon pjesëmarrje ose aksione është shfrytëzues i grantit, huas, përkatësisht përkrahjes financiare nga shteti ose nga njësia e vetëqeverisjes lokale,

- menjëherë, e më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes, emërimit, punësimit ose nga marrja e detyrës, Komisionit Shtetëror nuk ia paraqit çdo qarkullim me pronën shtetërore me të cilën hyn në marrëdhënie juridike

me personin juridik të themeluar prej tij ose anëtarit të familjes së tij ose në të cilin personi përgjegjës është anëtar i familjes së tij,

- gjatë kohëzgjatjes së mandatit, përkatësisht detyrës dhe në afat prej tri vitesh pas ndërprerjes së saj fiton në çfarëdo baze dhe në çfarëdo lloj forme të drejtash aksionare në personin juridik mbi të cilin ai ose organi në të cilin punon ose ka punuar kryen, përkatësisht ka kryer mbikëqyrje, përveç nëse këto të drejta i fiton në formë të trashëgimisë, përkatësisht nëse nuk i paraqet te Komisioni Shtetëror në afat prej 30 ditësh pas fitimit të tyre,

- nuk e njofton Komisionin Shtetëror për çdo zgjedhje, emërim ose punësim, avancim të anëtarit të familjes së tij në organin shtetëror, organin e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjes publike ose personit tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, në afat prej dhjetë ditësh pas zgjedhjes, emërimit, avancimit ose punësimit të kryer,

- në kundërshtim me dispozitat e ligjit i është ofruar dhuratë ose dobi tjetër lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare, nuk e refuzon ofertën e tillë,

- e shfrytëzon pozitën e vet duke ndikuar mbi personin tjetër në organin shtetëror, ndërmarrjen publike, institucionin publik ose personin tjetër juridik, që ai të miratojë ose të mos miratojë vendim të caktuar, të bëjë diçka, të lëshojë ose të pësojë, për shkak të realizimit të dobisë, komoditetit ose përparësisë për veten ose tjetrin.

(2) Gjorbë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik i cili në kundërshtim me nenin 52 paragrafi (1) i këtij ligji, do të paraqitet si shfrytëzues i grantit, huas, përkatësisht përkrahjes financiare nga shteti ose nga njësia e vetëqeverisjes lokale;

(3) Gjorbë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) i këtij neni.

#### Neni 106

Gjorbë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit i cili me personin zyrtar është person i afërt, për të cilin me arsye konsiderohet se ekziston interes që i lidh me personin zyrtar, nëse kryen mbikëqyrje supervizore ose mbikëqyrje kontrolluese mbi punën e tij.

#### Neni 107

Gjorbë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit zyrtar në ndërmarrjen publike ose personit tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, nëse:

- merr pjesë ose vendos në procedurën për zgjedhjen, emërimin ose punësimin ose është përfshirë si anëtar i trupit që e zbaton atë procedurë, ndërsa nuk do ta njoftojë udhëheqësin e institucionit ku kryen autorizime publike për të gjitha procedurat që mund të shkaktojnë konflikt interesash,

- kupton për rrethanat që sugjerojnë në ekzistimin e konfliktit të interesave dhe për këtë nuk kërkon të përjashtohet nga veprimi dhe vendimmarrja e mëtejshme,

- në afat prej 15 ditësh nga pranimi i vendimit nuk ndërmerr veprime për mënjanimin e konfliktit të interesave dhe për këtë nuk e njofton Komisionin Shtetëror,

- në procedurën e kontrollit Komisioni Shtetëror përcakton se prona dhe të ardhurat e personit zyrtar dhe personat lidhur me të nuk përputhen me të dhënat e

kontrollit të kryer, ndërsa personi zyrtar me kërkesë të Komisionit Shtetëror, në afat prej 15 ditësh, nuk dorëzon të dhëna të hollësishme për bazën për fitimin e pronës, në pajtim me nenin 93 të këtij ligji.

## Neni 108

Gjobjë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të subjektit ose të personit të autorizuar nga ai nga neni 76 paragrafi (4) të këtij ligji nëse nuk i dorëzon dokumentet, të dhënat dhe informatat me të cilat disponon në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga Komisioni Shtetëror.

## Neni 109

Gjobjë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të zgjedhur ose të emëruar, personit përgjegjës në ndërmarrjen publike, institucionin publik ose personit tjetër juridik i cili disponon me kapital shtetëror, noterit, përmbaruesit, nëpunësit administrativ të kategorisë A të përcaktuar me ligj ose personit të punësuar në kabinetet e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryetarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrave dhe sekretarit të përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shkak të kryerjes së detyrave të punës të këshilltarit të veçantë, nëse:

- gjatë zgjedhjes, emërimit, caktimit, përkatësisht punësimit, e më vonë në afat prej 30 ditësh nga dita e zgjedhjes ose emërimit, nuk parashtron te Komisioni Shtetëror listë anketuese përkatësisht deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në pajtim me nenin 82 të këtij ligji,
- nuk plotëson listë anketuese përkatësisht deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në afat prej 30 ditësh pas pushimit të funksionit përkatësisht punësimit.
- në afat prej 30 ditësh nuk e paraqet çdo rritje të pronës së tij, përkatësisht të pronës së anëtarit të familjes së tij, në pajtim me nenin 85 të këtij ligji.

## Neni 110

Gjobjë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet nëpunësit administrativ, gjyqësor dhe të prokurorisë publike nga neni 83 i këtij ligji, nëse:

- në afat prej 30 ditësh nga dita e punësimit nuk plotëson dhe nuk dorëzon në organin në të cilin është punësuar listë anketuese, përkatësisht deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat për të dhe për anëtarët e familjes së tij në pajtim me nenin 83 të këtij ligji,
- nuk plotëson dhe nuk dorëzon listë anketuese përkatësisht deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në afat prej 30 ditësh pas ndërprerjes së punësimit në organet nga neni 83 paragrafi (1) të këtij ligji,
- nuk paraqet ndryshime në gjendjen pronësore me fletëparaqitje të parashtruar në organin në të cilin është punësuar.

## Neni 111

Gjobjë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit zyrtar i cili me kërkesë të Komisionit Shtetëror, kur vepron për lëndën në

të cilën është përfshirë ai person, nuk do të paraqesë listë anketuese për gjendjen pronësore dhe deklaratë për interesa.

## Neni 112

Gjobjë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të institucionit përkatësisht organit i cili kryen zgjedhje dhe emërimet ose personit të autorizuar nga ai i cili në Komisionin Shtetëror pa prolongim, e më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhjes dhe emërimit, si dhe pas pushimit të funksionit, përkatësisht detyrës së personit të zgjedhur dhe emëruar nuk do t'i dorëzojë formular të plotësuar me të dhënat për personat nga neni 82 paragrafi (1) të këtij ligji (neni 91).

## Neni 113

Gjobjë në shumë prej 200 deri 400 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit udhëheqës të subjektit ose personit udhëheqës nga ai nga neni 94 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij ligji i cili nuk do t'i japë të gjitha informatat e nevojshme për përcaktimin e gjendjes faktike të cilat janë të rëndësishme për hetimin e pronës dhe gjendjes pronësore dhe interesave dhe nëse nuk e njoftojnë Komisionin Shtetëror për shkaqet për mosveprim.

## Neni 114

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurën për kundërvajtje e udhëheq dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Komisioni për kundërvajtje në Komisionin Shtetëror.

(2) Anëtarë të Komisionit për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, janë persona të autorizuar zyrtarë në Sekretariat, me shkallë përkatëse dhe lloj të përgatitjes profesionale dhe përvojë të nevojshme të punës të përcaktuara me ligj, prej të cilëve së paku një nga anëtarët është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudence.

(3) Para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës kundërvajtëse mbahet procedurë për barazim me dhënie të urdhërpagesës kundërvajtëse në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(4) Personat e autorizuar zyrtarë nga paragrafi (2) i këtij neni detyrohen të mbajnë evidencë për urdhërpagesat për kundërvajtje të lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

(5) Në evidencën nga paragrafi (4) i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat vijuese: emri dhe mbiemri, përkatësisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje që lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(6) Të dhënat personale nga paragrafi (5) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(7) Komisioni Shtetëror e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje.

## Neni 115

Përcaktimi i gjobjës bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

## Neni 116

Realizimi i të drejtës së mjetit juridik pas gjobës së shqiptuar dhe procedurës për të bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

**Kapitulli i dhjetë**

## DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

**Emërimi i anëtarëve të Komisionit Shtetëror**

## Neni 117

(1) Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë shpall konkurs për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Në procedurën për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror nga paragrafi (1) i këtij neni, afatet e parapara në nenin 12 të këtij ligji shkurtohen në pajtim me listën e afateve që e miraton Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë listën e afateve për zbatimin e procedurës për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror e publikon bashkë me shpalljen nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 118

(1) Me emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror në pajtim me dispozitat e këtij ligji, pushon mandati i anëtarëve të Komisionit Shtetëror të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Në kufizim të numrit të mandateve për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror llogariten edhe mandatet të cilat një person i ka kryer në përbërjet e Komisionit Shtetëror të zgjedhur në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15), pa marrë parasysh kohëzgjatjen e mandatit.

**Miratimi i akteve të nevojshme**

## Neni 119

(1) Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, Komisioni Shtetëror do t'i miratojë në afat prej gjashtë muajsh nga emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror në të zbatuar në procedurë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Deri në miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, do të zbatohen aktet nënligjore ekzistuese të miratuara në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15) dhe Ligjit për parandalim të konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 70/2007, 114/2009, 6/12 dhe 153/15).

(3) Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore nga paragrafi (1) i këtij neni paraqitja dhe kontrolli i gjendjes pronësore dhe interesave do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15) dhe Ligjit për parandalim të konfliktit të interesave

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 70/2007, 114/2009, 6/12 dhe 153/15) dhe akteve nënligjore që dalin prej tyre.

(4) Listat anketuese, deklaratat për interesat dhe fletëparaqitjet për ndryshime në gjendjen pronësore të parashtruara deri në ditën e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore nga paragrafi (1) i këtij neni, konsiderohen si deklaratat të parashtruara për gjendjen pronësore dhe interesat përkatësisht fletëparaqitjet për ndryshime në gjendjen pronësore në pajtim me këtë ligj.

(5) Komisioni Shtetëror në afat prej 60 ditësh nga konstituimi i tij do të caktojë formular për deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat.

(6) Personat që nuk kanë pasur obligim të parashtrorinë lista anketuese dhe deklaratat të interesave, në pajtim me Ligjin për parandalim të korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15) dhe Ligjit për parandalim të konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 70/2007, 114/2009, 6/12 dhe 153/15), janë të detyruar që të parashtrorinë deklaratë për gjendje pronësore dhe interesa në afat prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të formularit nga paragrafi (5) i këtij neni.

(7) Komisioni Shtetëror ka të drejtë të miratojë vendim për shpallje të thirrjes ndaj personave që kanë parashtruar lista anketuese dhe deklaratat të interesave, në pajtim me Ligjin për parandalim të korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15) dhe Ligjit për parandalim të konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 70/2007, 114/2009, 6/12 dhe 153/15) të dorëzojnë deklaratat në formular nga paragrafi (5) i këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të thirrjes.

## Neni 120

(1) Në afat prej një muaji nga dita e emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Komisioni Shtetëror organizon marrje të listave anketuese, deklaratave për interesat dhe fletëparaqitjeve për ndryshime në gjendjen pronësore të cilat nëpunësit administrativë të kategorisë A të përcaktuar me ligj i kanë parashtruar te institucionet përkatësisht organet në të cilat janë emëruar. Marrjen e realizon komisioni i formuar nga Komisioni Shtetëror.

(2) Institucionet përkatësisht organet në të cilat janë emëruar nëpunësit administrativë të kategorisë A të përcaktuar me ligj detyrohen që të veprojnë për kërkesat të cilat Komisioni Shtetëror ua dërgon për shkak të realizimit të marrjes nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 121

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për parandalim të korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15) dhe Ligji për parandalim të konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 70/2007, 114/2009, 6/12 dhe 153/15).

**Hyrja në fuqi e ligjit**

## Neni 122

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".



*Службен весник*  
на Република Македонија



[www.slvesnik.com.mk](http://www.slvesnik.com.mk)

[contact@slvesnik.com.mk](mailto:contact@slvesnik.com.mk)

Издавач: ЈП СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА, ц.о. – Скопје  
бул. „Партизански одреди“ бр. 29. Поштенски фах 51.  
Директор и одговорен уредник – Мартин Костовски  
телефон: +389-2-55 12 400  
телефакс: +389-2-55 12 401

Претплатата за 2019 година изнесува 10.100 денари.  
„Службен весник на Република Македонија“ излегува по потреба.  
Рок за рекламации: 15 дена.  
Жиро-сметка: 300000000188798.  
Делопент на Комерцијална банка, АД – Скопје.  
Печат: Печатница ЕВРОПА 92 ДООЕЛ, Кочани.  
Цената на овој број е 120 денари.

ISSN 0354-1622



2019012